

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

FUSHA: KARRIERA DHE AFTËSITË PËR JETËN



TIRANË, 2010

AUTOR:

MIRELA ANDONI
ALQI MUSTAFAI
MERITA SHUKA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

LËNDA: EDUKIMI PËR KARRIERËN
KLASA 11^{të} dhe 12^{të}

TIRANË, 2010

PËRMBAJTJA

I. Lënda “Edukimi për karrierën” në kurrikulën e re të gjimnazit

I.1 Vështrim i përgjithshëm mbi programin “Edukimi për karrierën”

- Terminologjia kyç- konceptet;
- Struktura e programit

I.2 Zhvillimi i aftësive

I.3 Fusha dhe përmbajtja

I.4 Mundësitë kurrikulare për integrimin e lëndës “Edukimi për karrierën” me lëndët e tjera

1.5 Objektivat specifike të arritjes të lëndës “Edukimi për karrierën”

2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës “Edukimi për karrierën”

3. Vlerësimi i nxënësit

Fusha e orientimit në karrierë përfshin një sërë veprimtarish që përcaktohen për të orientuar, informuar, këshilluar të rinjtë të zgjedhin drejtimin e mundshëm për arsim apo punësim. Orientimi për karrierë është çështje e rëndësishme e politikave të arsimit dhe politikave në Shqipëri që ka ardhur si rrjedhojë e përshtatjes së individit me ndryshimet e vazhdueshme në tregun e punës. Këto politika nuk prekin vetëm moshat e reja që synojnë hyrjen në karrierë por edhe të rritur që kërkojnë përshtatjen me ndryshimet në tregun e punës duke synuar orientimin për gjatë gjithë jetës.

Orientimi në karrierë realizohet përmes disa fushave të veprimtarisë:

- informacionit mbi karrierën
- edukimit mbi karrierën
- këshillimit për karrierën.

Bazuar në prirjet evropiane dhe ato botërore të orientimit në karrierë, politikat arsimore kanë parë si domosdoshmëri futjen në kurrikulën e re të gjimnazit në klasat e 11-të, 12-të të lëndës “Edukimi për karrierën”, mes së cilës synohet edukimi i individit për të realizuar sipërmarrjen për karrierën e tij dhe njëkohësisht për sipërmarrje modeste sociale.

1. Lënda “Edukimi për karrierën” në kurrikulën e re të gjimnazit

Nëpërmjet kësaj lënde nxënësit identifikojnë dhe hulumtojnë qëllimet e karrierës, zbatojnë aftësitë e komunikimit dhe mendimin kritik, zhvillojnë aftësitë punë kërkuese dhe planifikojnë, marrin vendim për shkollimin, trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin.

Formimi i karrierës është një proces që zgjat gjatë gjithë jetës. Ai fillon në familje, zhvillohet gjatë periudhës së shkollimit si dhe përvojave të punës dhe shfaqet, njehsohet me aftësinë e individit për të marrë vendime për të ardhmen e tij, në përshtatje me statusin e kualifikimit dhe me ndryshimet e tregut të punës.

Përmbushja e objektivave të kësaj lënde realizohet përgjatë 2 viteve, në klasën e 11-të dhe 12-të në **54 orë**, përkatësisht 36 orë në klasë të 11-të dhe 18 orë në të 12-tën.

1.5. Vështrim i përgjithshëm mbi programin “Edukimi për karrierën”

Nëpërmjet kësaj lënde synohet të zhvillohen te nxënësit aftësitë për të zbuluar mundësitë e karrierës, si dhe për të vetëvlerësuar interesat dhe prirjet me qëllim vendimarrjen për shkollimin/trajnimin e mëtejshëm dhe punësimin, për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë.

“Edukimi për karrierën” në këtë nivel shkollimi synon që , nxënësi/ja:

- të përdorë dhe menaxhojë njohuritë, shprehitë e marra në

lëndë të ndryshme në lidhje me hulumtimin, planifikimin dhe vendimarrjen për karrierën;

- të përdorë familjen, shkollën, biznesin dhe sipërmarrjet nga komuniteti, si burime për të hulumtuar ndikimin e tyre në karakterin personal me qëllim planifikimin e karrierës;
- të përdorë njohuri, shprehje dhe ekspertizë nga një gjerësi burimesh me qëllim përmbushjen e qëllimeve të paracaktuara nga vetë ai/ajo për planifikimin e karrierës.
- të hulumtojë dhe planifikojë karrierën duke analizuar detyra dhe raste të suksesshme nga jeta e të rriturve, bota e punës dhe sipërmarrja;
- të vlerësojë në mënyrë kritike, në përputhje me interesat, prirjet dhe cilësitë vetjake, mundësitë e tij/saj për karrierën duke marrë parasysh konsumin dhe buxhetin personal, shëndetin dhe përgjegjësitë sociale, si dhe prirjet e tregut të punës;
- të planifikojë hapat për karrierën bazuar në vendimmarrje.
- të zbatojë elemente të sipërmarrjes në projekte konkrete.

Kjo lëndë fokusohet në dy fusha atë të ***edukimit për karrierë dhe sipërmarrjen***. Programi i kësaj lënde përshkohet nga tri linja:

- Hulumtimi i karrierës;
- Vetëvlerësimi;
- Vendimmarrja për karrierën.

► Terminologjia kyç - konceptet

Programi përfshin një numër konceptesh bazë mbi të cilat mbështetet zhvillimi i lëndës “Edukimi për karrierën”

Në linjën e parë ‘Hulumtimi për karrierën dhe sipërmarrjen’ zhvillohen dhe përdoren konceptet mbi:

- punën, llojet e punëve, profesionin, fushën profesionale;
- karrierën, zhvillimin e karrierës; orientimin e karrierës, informimin e karrierës;
- punëdhënësin, punëmarrësin;
- arsimin, arsimin profesional, kualifikimin profesional, trajnimin;
- tregun e punës; sipërmarrës, ekonomi globale, performancë.

Në linjën e dytë “Vetëvlerësimi”, zhvillohen dhe përdoren konceptet mbi:

- vetëvlerësimin;
- stilin e të nxënit;
- aftësitë;
- vlerat në punë;
- tipet e personalitetit;
- grupin e interesave.

Në linjën e tretë “Planifikimi/vendimmarrja për karrierën”, zhvillohen dhe përdoren konceptet mbi:

- intervistën për punë;
- kërkesën për punë;
- aplikimin për punë;
- “curriculum vitae”;
- planin e veprimit;
- analizën “SË OT”;
- vlerësimin; feed back-un.

Në numrin e koncepteve të përmendura më sipër, merr rëndësi të veçantë njohja nga nxënësit dhe përdorimi i disa koncepteve bazë, që do të përdoren gjatë gjithë zhvillimit të programit mësimor si :

▪ **Puna, profesioni, fusha profesionale;**

Nxënësi duhet të dallojë kuptimin dhe ndryshimin e këtyre koncepteve me qëllim fokusimin e drejtë në planifikimin e karrierës.

- **Karriera, orientimi për karrierë, informimi për karrierë;**

Nxënësi duhet të dallojë kuptimin për karrierën dhe të aftësohet për të marrë informacion, të vetë orientohet për karrierën apo të njohë dhe përdorë instrumentet, mjetet, metodologjitë për orientimin në karrierë.

- **Arsimi, arsimit profesional, kualifikimi profesional, certifikimi;**

Nxënësi duhet të krijojë një përfytyrim të qartë mbi të përbashkëtat dhe ndryshimet mes arsimit dhe kualifikimit, arsimit të përgjithshëm dhe atij profesional si dhe trajnimit profesional. Gjatë trajtimit të këtyre koncepteve duhet trajtuar rëndësia që ka certifikimi për karrierën e individit.

- **Tregu i punës; sipërmarrje, ekonomi globale, performancë.**

Nxënësi duhet të dallojë kuptimin dhe dallimet mes termave të mësipërme dhe të shpjegojë rëndësinë e performancës së individit në tregun global të punës.

► **Struktura e programit**

Programi përmban rubrikat e mëposhtme:

1. Synimi i lëndës
2. Objektivat e përgjithshëm
3. Objektivat sipas linjave
4. Kërkesa të “Edukimit për karrierën” ndaj lëndëve të tjera
5. Kërkesa për zbatimin e programit
6. Vlerësimi.

Të gjitha rubrikat të strukturuar në mënyrë hierarkike, japin një panoramë të përmbajtjes së kësaj lënde dhe njëkohësisht sugjerojnë mënyrën e realizimit të kësaj përmbajtje në klasë.

Lënda “Edukimi për karrierën” përfshihet në lëndët e kurrikulës bërthamë, pra, është e detyrueshme për të gjithë nxënësit e klasës së 11-të dhe 12-të.

Përvetësimi i këtij programi nga nxënësit konsiderohet i mjaftueshëm për edukimin e nxënësit për të zgjedhur karrierën përmes fokusimit në tregun e shkollimit dhe punësimit. Ky program krijon një bazament të mjaftueshëm për orjentimin e nxënësve për gjatë gjithë jetës.

Lënda “Edukimi për karrierën” dhe programi i saj është risi si për përmbajtjen që trajton dhe për metodologjinë që sugjeron. Ky program e mbështet arritjen e nxënësit në mënyrat, teknikat e hulumtimit, vetëvlerësimit dhe vendimmarrjes, të cilat drejtohen nga mësuesi dhe realizohen në mënyrë të pavarur nga nxënësi.

Programi është ndarë në dy pjesë, pjesa e parë me 36 orë fokusohet në edukimin e nxënësit për sipërmarrje individuale në lidhje me karrierën. Pjesa e dytë, e planifikuar me 18 orë në klasën e 12-të ka fokus sipërmarrjen sociale. Të dyja këto pjesë përshkohen nga tri linja që janë të njëjta me hapat që duhet të ndjekë individi në jetë për të planifikuar dhe marrë vendime për karrierën e tij dhe për veprimtari të tjera sipërmarrëse personale apo më gjerë. Linjat e planifikuara të programit vijnë njëra pas tjetrës. ***Çdo linjë përmes objektivave paraqet sjelljen e pritshme të nxënësit***, mësuesi bazuar në këto objektiva përzgjedh tematikat dhe planifikon kohën për realizimin e tyre, brenda volumit kohor që ka sugjeruar programi. Gjithashtu bazuar në program, mësuesi planifikon metodologjitë dhe përgatit kushtet, mediat didaktike për realizimin e programit.

Klasa 11-të

Linja 1: Hulumtimi i karrierës sugjerohet të zhvillohet në 18 orë mësimore.

Linja 2: Vetëvlerësimi për karrierën sugjerohet të zhvillohet në 8 orë mësimore.

Linja 3: Planifikimi dhe vendimmarrja për karrierën sugjerohet të zhvillohet në 10 orë mësimore.

Klasa 12-të

Linja 1: Hulumtimi i sipërmarrjes sugjerohet të zhvillohet në 6 orë mësimore.

Linja 2: Vetëvlerësimi për sipërmarrjen sugjerohet të zhvillohet në 4 orë mësimore.

Linja 3: Planifikimi dhe vendimmarrja për sipërmarrjen sugjerohet të zhvillohet në 8 orë mësimore.

Bazuar në karakterin aplikativ të lëndës “Edukimi për karrierën”, programi ka planifikuar që afërsisht 40% e orëve mësimore totale të përdoren nga mësuesi dhe nxënësi për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe 60% e tyre për përpunimin e tyre (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor). Ky raport nënkupton që veprimtaritë praktike, diskutimet, punët e pavarura, prezantimet kanë peshë të konsiderueshme për realizimin e objektivave të programit duke i shërbyer në mënyrë të drejtpërdrejtë realizimit të synimit të programit. ***Mësuesi sugjerohet të përdorë formate të njëjta për detyrat e pavarura të nxënësve*** të cilat do të lehtësojnë diskutimet dhe vlerësimet e nxënësve për çështje të veçanta.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë në program është rekomanduese. Mësuesit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën linjë. Mësuesi mund të vendosë të përparojë

më ngadalë, kur vëre se nxënësit e tij hasin vështirësi në përmbushjen e objektivave të linjës. Mund të ecë më shpejt, kur nxënësit e tij shfaqin një përvetësim të kënaqshëm.

1.2 Zhvillimi i aftësive

Edukimi për karrierë zhvillon te nxënësi aftësi për të hulumtuar në lidhje me tregun e shkollimit dhe punësimit, aftësi për të vlerësuar veten dhe aftësi për të realizuar sipërmarrje bazuar në një plan të studiuar mirë.

Referuar teorive të pedagogjisë zhvillimi i aftësive në një individ realizohet përmes zhvillimit të *aftësive* dhe *strategjive të të nxënësve*. Këto realizohen përmes aftësimit të nxënësve për të mbledhur, interpretuar, organizuar, analizuar, vlerësuar dhe sintetizuar informacionin si dhe nëpërmjet përpunimit, transferimit, përshtatjes së informacionit të marrë në kohë dhe situata të ndryshme.

Për të arritur objektivat e programit të lëndës “Edukimi në karrierë”, nxënësit aftësohen sa më poshtë:

A. Për të mbledhur informacion

Për të realizuar këtë nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të indentifikojnë burime të ndryshme informacioni (gazeta, revista, harta, diagrama, fjalor etj);
- Të dallojnë përparësitë dhe kufizimet e burimeve të ndryshme të informacionit;
- Të identifikojnë tipet dhe llojet e informacionit të nevojshëm;
- Të dallojnë qëllimin e përdorimit të informacionit;
- Të lokalizojnë informacionin duke dalluar elementet kryesore, idete kryesore dhe elementet mbështetëse në të;

- Të organizojnë në mënyrë të rregullt informacionin e mbledhur sipas formateve të dhëna;
- Të zbatojnë formatet e përcaktuara dhe rregullat për të kryer intervista me anëtarë të familjes, me persona të ndryshëm në komunitet nga biznesi etj.

B. Për të përdorur informacionin

Për të realizuar këtë, nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të klasifikojnë dhe kategorizojnë të dhënat duke i vendosur në mënyrë kronologjike dhe logjike si dhe duke identifikuar dallimet dhe ngjashmëritë e të dhënave;
- Të gjykojnë mbi të dhënat duke dalluar faktet nga opinionet;
- Të bëjnë përgjithsime nga të dhënat e marra;
- Të për zgjedhin të dhënat sipas rëndësisë dhe nevojës për t'i përdorue më tej.

C. Për të prezantuar informacion

Për të realizuar këtë nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të flasin qartë dhe me efektivitet duke respektuar kohën që i është dhënë në dispozicion;
- Të përdorin mjete të ndryshme vizuale për të komunikuar idete;
- Të shkruajnë duke paraqitur mendim të qartë logjik;
- Të përdorin mjete jo verbale të komunikimit gjatë prezantimit;
- Të zbatojnë formatet dhe standardet e kërkura nga mësuesi për prezantim;
- Të zbatojnë tematikën, objektivat e prezantimit;
- Të punojnë në mënyrë individuale dhe në grup për të përgatitur

dhe prezantuar informacionin.

D. Për të marrë pjesë dhe ndërvepruar në grup

Për të realizuar këtë nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të ndërveprojnë me qendrimet pozitive duke respektuar këndvështrime të ndryshme nga pjestarët e grupit;
- Të marrin pjesë në planifikimin dhe diskutimin në grup duke ndjekur procedurën demokratike që ndihmojnë vendimarrjet në grup;
- Të marrin përgjegjësi dhe të realizojnë detyrat individuale ose të grupit;
- Të përcaktojnë çështjet bazë për të cilat do të bashkëpunohet;
- Të krijojnë hipoteza ose alternativa të ndryshme për veprim;
- Të zbatojnë afatet e përgatitjes së detyrave në grup;
- Të menaxhojnë drejt kohën në punën në grup.

E. Për të shmangur dhe zgjidhur konflikte apo situata të ndryshme problemore.

Për të realizuar këtë nxënësit duhet të jenë të aftë:

- Të përcaktojnë apo identifikojnë problemin në raste të ndryshme të investigimeve në familje, komunitet etj;
- Të ngrenë hipoteza në lidhje me dëshirat dhe pritshmëritë e tyre dhe të investigojnë të dhëna;
- Të planifikojnë dhe marrin vendime bazuar në investigimet e bëra;
- Të dallojnë vlerat e konflikteve dhe rrugët për menaxhimin e tyre;
- Të vlerësojnë, rivlerësojnë mundësitë për arritjen e karrierës së dëshiruar si dhe të përcaktojnë vendimin duke menaxhuar situata të mundshme problemore.

1.3. Fusha dhe përmbajtja

Lënda “Edukimi për karrierën” së bashku me lëndën e “Aftësimin për jetën”, bën pjesë në fushën “Karriera dhe aftësimi për jetën”.

Kjo lëndë, si të gjitha lëndët që zhvillohen në kurrikulën bërthamë, ka një kod, i cili gjendet në kopertinën e çdo programi dhe që përfaqëson çdo lëndë në planin mësimor. Ai është:

FUSHA: KARRIERA DHE AFTËSIMI PËR JETËN

LËNDA: EDUKIMI PËR KARRIERËN

KODI: 5.2.B

- **Përmbajtja**

Programi “Edukimi për karrierën” trajton njohuri në lidhje me tregun e punës dhe atë të shkollimit, në këtë program trajtohet kuptimi mbi punën, profesionin dhe karrierën, rrugët (drejtimet) e karrierës profesionale; kualifikimet e përgjithshme dhe ato profesionale si dhe klasifikimi i tyre; sistemet formale, informale dhe joformale të kualifikimeve; veçoritë e tregut të punës dhe tregut të kualifikimeve; kuptimin dhe mënyrat e hulumtimit të karrierës; burimet e informacionit për punësim dhe kualifikim etj.

Përmes këtij programi synohet që nxënësi përmes veprimtarive praktike të vlerësojë veten në lidhje me tipin e personalitetit, aftësitë dhe cilësitë, komunikimin, seksualitetin, sensualitetin si elemente të rëndësishëm për t’i përputhur më tej gjatë planifikimit dhe vendimmarrjes për karrierën me interesat, dëshirat, mundësitë etj. Nëpërmjet realizimit të këtij programi në shkollë nxënësit hartojnë planin e karrierës dhe marrin vendime për karrierën, kjo është dhe sipërmarrja e parë e tyre.

Në klasën e 12-të, programi fokusohet në kuptimin e sipërmarrjes dhe hulumtimin e cilësisë së personave sipërmarrës dhe vetëvlerësimin në lidhje me aftësitë sipërmarrëse. Nëpërmjet veprimtarive praktike synohet planifikimi, organizimi dhe realizimi i një veprimtarie sipërmarrëse

e karakterit social. Përmbajtja e këtij programi fokusohet vetëm në sipërmarrjen sociale (pra, jo në sipërmarrje biznesi).

Përmbajtja në program pasqyrohet përmes objektivave të parashtruara në të gjitha linjat. Këto objektiva janë të detyruara për të gjithë nxënësit.

Për shembull, objektivi:

-Nxënës/i-ja të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme

Ky objektivi do të thotë se të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të identifikojnë dëshirat dhe interesat për profesione të ndryshme bazuar në hetimin që ata kanë bërë në tregun lokal apo rajonal të punës. Gjithashtu në lidhje me këtë objektivi të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që nëpërmjet hetimit të kryer të identifikojnë dëshirat dhe interesat për profesione të ndryshme si dhe të prezantojnë, diskutojnë dhe argumentojnë hetimin e kryer.

• **Përpunimi i njohurive**

Bazuar në synimet e lëndës "Edukimi për karrierën", raporti mes njohurive të reja dhe përpunimit të tyre i jep përparësi përpunimit të njohurive me 60% të totalit të orëve. Përpunimi realizohet përmes:

- përsëritjeve brenda një linje të njohurive bazë të tij (konceptet themelore);
- diskutimit në lidhje me termat, konceptet apo gjetjet;
- prezantimit të hulumtimeve, detyrave, intervistave etj;
- testimit të njohurive-bazë;
- integritit dhe njohurive të reja të një linje me njohuritë e linjave paraardhëse;
- integritit të njohurive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera, ndonëse këto për shkak të karakterit të veçantë që ka lënda, përshkojnë çdo orë

mësimore, gjatë përpunimit atyre u duhet kushtuar kohë e posaçme;

- përsëritjes vjetore e cila mban parasysh rishikimin dhe vlerësimin e portofolit të karrierës i cili do të mbështesë vendimarrjen për të ardhmen. Pavarësisht nga ndarja në linja ose në kapituj, lënda duhet parë si një e tërë;
- vlerësimi vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të realizojnë detyra, intervista, veprimtari praktike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj.

Në orët mësimore që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon detyra apo veprimtari me nismën e tyre ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto veprimtari mund të kenë pikënisje situata aktuale apo edhe nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme veçanërisht kultivimit të:

- *aftësive të përgjithshme*, si: aftësia e komunikimit, e menaxhimit të informacionit, e zgjidhjeve problemore, e të menduarit kritik dhe krijues;
- *aftësive të posaçme lëndore*, si: identifikimi i cilësive dhe personalitetit; fokusimi në karrierë; aftësia për të vendosur në kohë, hapësirë; aftësia për të kuptuar, analizuar dhe argumentuar lidhjet shkak-pasojë; aftësia për të hetuar, interpretuar dhe parashikuar; aftësia krijuese për shkrimin e një eseje, duke sjellë një opinion dhe qëndrim të vetin; aftësi krahasuese në lidhje me krahasimin dhe renditjen e përparësive të profesioneve të ndryshme dhe dëshirave personale; aftësia për të përdorur teknologjinë e informacionit si mjet burimor; aftësi për prezantimin e qartë të

- njohurive, opinioneve, mendimeve, aftësia për punë kërkimore, punë në grup etj.
- *formimit të qëndrimeve*, si qëndrimi etik-social etj, gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Përmbajtja e programit është e ndërtuar përmes 3 linjave bazë të cilat kërkojnë të aftësojnë nxënësit jo vetëm të njohin historinë, por dhe ta përdorin atë për të kuptuar dhe vlerësuar të sotmen dhe perspektivën.

Çdo linjë ka përmbajtjet si më poshtë:

Linja 1: Hulumtimi i karrierës

Kjo linjë do t'i krijojë mundësi nxënës/it-es të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës, rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional në lidhje me statusin e punësimit;

Në këtë linjë nxënës/i-ja paraqet veçoritë e sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri, përmes veprimtarive praktike ka mundësi të dallojë prirjet e zhvillimit të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe burimet kryesore të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punësimit.

Përmes intervistave dhe bisedave me familjarë të tij nxënësi paraqet ndikimin e profesioneve të ndryshme në organizimin e jetës së përditshme, rëndësinë e formave të ndryshme të punës duke përfshirë punën në familje, punën vullnetare, në komunitet si dhe ndryshimet kryesore midis shkollës dhe punës.

Kjo linjë i krijon mundësi nxënës/it-es të përzgjedhë profesionet e dëshiruara duke evidentuar shkollimin dhe trajnimin e duhur për t'u rritur në karrierë.

Linja 2: Vetëvlerësimi

Linja do të ndihmojë nxënësit të realizojnë vetëvlerësimin duke identifikuar, argumentuar, vlerësuar dhe rivlerësuar dëshirat personale për profesione të ndryshme duke ballafaquar këto me aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme, shëndetin personal, rolin gjinor, sensualitetin, seksualitetin, intimitetin në raport me profesionet e përzgjedhura.

Linja 3 : Planifikimi vendimarrja për karrierën

Kjo linjë ka për qëllim të shpjegojë, analizojë dhe hartojë në mënyra të ndryshme kërkesën për punë, formën e aplikimit, “curriculum vitae” si dhe të aftësohet për intervistën e punës duke respektuar rregullat e sjelljes, komunikimit, paraqitjes. Në këtë linjë nxënësi aftësohet të hartojë qëllimin dhe objektivat për karrierën, të analizojë portofolin e karrierës si dhe të planifikojë afatet kohore për çdo objektiv për karrierën, të planifikojë buxhetin personal lidhur me karrierën, bursat e mundëshme me synim përfundimtar planifikimin e strategjive për karrierën personale.

1.4. Mundësitë kurrikulare për integrimin e lëndës “Edukimi për karrierën” me lëndët e tjera.

Edukimi për karrierën	1. Matematika
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kryejë veprime matematikore në funksion të llogaritjes së buxhetit familjar dhe personal, për llogaritjen e nivelit të jetesës; - të interpretojë tabela, grafikë e diagrama statistikore që lidhen me prirjet e tregut të punës dhe punësimin.

<p>Edukimi për karrierën</p>	<p>2. Gjuha shqipe</p>
<p>Për të gjitha linjat</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë dhe të dijë kuptimin e termave dhe të koncepteve gjuhësore si: karriera, vendimmarrja, profesioni, kualifikimi, sipërmarrja, vetëvlerësimi, menaxhimi, konflikti, stresi, komunikimi, planifikimi etj; - të përdorë formatet e një kërkese, shkrese zyrtare, CV-je dhe formulari aplikimi; - të analizojë dhe interpretojë tekste të ndryshme në rastet e kërkimit të punës dhe analizës së tregut të punës; - të përdorë forma të ndryshme komunikimi në raste të intervistave, paraqitjes, diskutimit; - të shprehë opinione të arsyetojë, diskutojë, argumentojë dhe të bëjë debat në lidhje me tematika që lidhen me karrierat, sipërmarrjet e suksesshme, rolin gjinor dhe shëndetin në zgjedhjet e ardhshme; - të zhvillojë dialogë, të dëgjojë me vëmendje, të mbajë në vëmendje opinione, pikëpamje dhe të kontrollojë emocionet; - të bëjë prezantime (paraqitje) duke përdorur teknika të ndryshme.
<p>Edukimi për karrierën</p>	<p>3. Gjuha e huaj</p>

<p>Për të gjitha linjat</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë dhe interpretojë informacione në gjuhë të huaj në lidhje me karriera dhe sipërmarrje të suksesshme, njoftime për punësim; - të shfrytëzojë fjalorin terminologjik në gjuhë të huaj.
<p>Edukimi për karrierën</p>	<p>4. TIK</p>
<p>Për të gjitha linjat</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë programe të ndryshme për punët e pavarura dhe prezantimet e ndryshme (si ëord, excel, poëer point etj); - të përdorë komunikimin elektronik (e-mail, rrjetin e brendshëm, internetin etj) për të komunikuar dhe bashkëpunuar me të tjerët.
<p>Edukimi për karrierën</p>	<p>5. Qytetari</p>
<p>Për të gjitha linjat</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të përdorë konceptet e familjes dhe komunitetit për të bërë analiza të ndryshme; - të përdorë dhe të shfrytëzojë forma të ndryshme komunikimi; - të vlerësojë mendime të tjetrit pa e paragjykuar atë; - të zhvillojë dialogë, të dëgjojë me vëmendje, të tërheqë opinione dhe të shprehë pikëpamje duke qenë tolerant dhe joparagjykuës; - të njohë dhe shfrytëzojë mentalitetin familjar dhe të. komunitetit në ndihmë të planifikimit të karrierës.

Edukimi për karrierën	6. Njohuri për ekonominë
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë rolin e degëve të veprimtarive të ndryshme ekonomike në shoqëri; - të shpjegojë thelbin e ekonomisë së tregut dhe mekanizmat e funksionimit të saj; - të shpjegojë si vendoset çmimi i punës; - të përdorë konceptet e kërkesës dhe të ofertës për marrjen e vendimeve për punë; - të shpjegojë tregun e punës dhe faktorët që ndikojnë në të; - të analizojë tregun e punës për vendimmarrje; - të përdorë konceptet bazë për operacionet bankare, pagën, fitimin, TVSH-në, koston, koston oportune, ekonominë globale, buxhetin; - të shpjegojë thelbin e sipërmarrjes dhe bazat e saj.
Edukimi për karrierën	7. Biologjia
Për të gjitha linjat	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të analizojë efektet e drogës, alkoolit, duhanit, HIV-it, shtatzanisë së padëshirueshme, abuzimit seksual etj; <p>Në vendimmarrje;</p> <ul style="list-style-type: none"> - të vlerësojë efektin e barnave duke marrë parasysh dozat, efektet anësore, mënyrat e marrjes, përfitimet.
Edukimi për karrierën	8. Gjeografia

<p>Për të gjitha linjat</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të shfrytëzojë mjete mësimore si hartat, globin etj; - të përdorë hartën për të përcaktuar dhe analizuar tregje të ndryshme pune në varësi të kushteve gjeografike; - të shpjegojë fenomenin e migrimit dhe ta përdorë në funksion të tregut të punës.
------------------------------------	--

1.5. Objektivat e arritjes për lëndën “Edukimi për karrierën” për klasën e 11-të dhe 12-të.

Përmbajtja e lëndës, sikurse është parashtruar dhe më lart paraqitet përmes objektivave. Arritja me sukses e këtyre objektivave nënkupton përmbushjen e tyre përmes procesit të të nxënës. Nxënësit shfaqin arritjen e objektivit në nivele të ndryshme, që nënkupton një diferencim të tyre përmes rezultatit të njësuar të vlerësimit me notë.

Objektivat e programit duhet të specifikohen nga mësuesi në nivele të ndryshme, për realizimin e çdo ore mësimore. Po t’i referohemi shembullit të dhënë më sipër në lidhje me sqarimin e kuptimit për nivelet e arritjes, pra objektivit:

- Nxënës/i-ja të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme.

Në lidhje me këtë objektiv, një nivel arritjeje është identifikimi i profesioneve që i interesojnë dhe që i dëshiron, bazuar në grumbullimin dhe përzgjedhjen e informacionit në lidhje me to.

Një nivel më i lartë se ky është interpretimi në lidhje me interesin për këto profesione.

Një nivel edhe më i lartë do të ishte gjykimi për profesionet e përzgjedhura, duke mbajtur qëndrim personal bazuar në argumente dhe duke parashikuar perspektivat e së ardhmes.

Gjithmonë mësuesi mban parasysh që jo për të gjithë nxënësit do të pretendohet i njëjti nivel i arritjes.

Më poshtë po paraqesim shembuj të specifikimit të disa objektivave të programit në nivele të ndryshme të arritjes. Bazuar në këto shembuj mësuesi specifikon objektivat e programit me qëllim realizimin e procesit mësimor, planifikimin e kushteve dhe mediave për realizimin e mësimit.

OBJEKTIVAT E NDARE SIPAS 3 NIVELEVE TË ARRITJES SË NXËNËSVE	
LINJA 1	HULUMTIMI I KARRIERËS
<p>Linja 1: Për objektivat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës; - të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional, në lidhje me statusin e punësimit; - të shpjegojë sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri. 	<p>Niveli i bazë</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë kuptimin e punës, profesionit, karrierës; ▪ të shpjegojë kuptimin e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional në veçanti; ▪ të shpjegojë kuptimin për sistemin formal, informal dhe jo formal në punësim.
	<p>Niveli i mesëm</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të dallojë ndryshimet mes punës, profesionit dhe karrierës; ▪ të argumentojë me shembuj ndikimin e kualifikimit në punësim; ▪ të dallojë ndryshimet mes sistemit formal, joformal dhe informal të kualifikimit.
	<p>Niveli i lartë</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë përmes shembujve ndryshimet mes punës, profesionit, karrierës; ▪ të dallojë me shembuj konkretë ndikimin e kualifikimit të përgjithshëm dhe atij profesional në punësim; ▪ të evidentojë përmes shembujve konkretë në skemën e sistemit formal të kualifikimit mundësi për rritje në karrierë.

<p>Linjal: Për objektivat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të hetojë cilësitë dhe aftësitë e personave sipërmarrës; - të paraqesë veçoritë e sipërmarrjeve në komunitet duke iu referuar produktit, shërbimit, tregut dhe forcave të punës. 	<p>Niveli bazë</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë kuptimin për sipërmarrjen sociale dhe atë të biznesit; ▪ të shpjegojë kuptimin e produktit, shërbimit, tregut dhe forcave të punës.
	<p>Niveli i mesëm</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të evidentojë nga realiteti cilësi dhe aftësi të personave sipërmarrës; ▪ të evidentojë shembuj të produktit, shërbimit, tregut dhe forcave të punës nga sipërmarrje të ndryshme në komunitet.
	<p>Niveli i lartë</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë cilësitë dhe aftësitë e personave sipërmarrës dhe rrugën e tyre të karrierës; ▪ të dallojë analizojë me shembuj dallimet dhe realizimet e sipërmarrjeve në komunitet duke iu referuar produktit, shërbimit, tregut dhe forcave të punës.

OBJEKTIVAT E NDARA SIPAS 3 NIVELEVE TË ARRITJES SË NXËNËSVE	
LINJA 2	VETËVLERËSIMI
<p>Linja 2: Për objektivat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme. - të bëjë vetëvlerësimin duke mbajtur parasysh dëshirat dhe interesat që lidhen me profesione të ndryshme; 	<p>Niveli bazë</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të paraqesë listën e dëshirave dhe interesave personale për profesione të ndryshme; ▪ të paraqesë tipin e personalitetit, cilësitë, aftësitë, prirjet personale.
	<p>Niveli i mesëm</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të prezantojë dhe argumentojë listën e përzgjedhur të dëshirave dhe interesave personale për profesione të ndryshme; ▪ të argumentojë me shembuj tipin e personalitetit, cilësitë, aftësitë, prirjet personale.
	<p>Niveli i lartë</p> <p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë mundësitë e realizimit të dëshirave dhe interesave personale për profesione të ndryshme; ▪ të analizojë lidhjen mes dëshirave, interesave personale për profesione të ndryshme me tipin e personalitetit, cilësitë, aftësitë, prirjet personale.

<p>Linja 2: Për objektivat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë anët e dobëta dhe të forta personale në lidhje me aftësitë sipërmarrëse; - të identifikojë mundësitë personale për realizimin e një veprimtarie sipërmarrëse 	<p>Niveli bazë</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të paraqesë listën e aftësive sipërmarrëse; ▪ të listojë mundësitë personale për realizimin e një veprimtarie sipërmarrëse.
	<p>Niveli i mesëm</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të argumetojë me shembuj konkretë aftësitë sipërmarrëse; ▪ të evidentojë me shembuj realizimin e një veprimtarie sipërmarrëse.
	<p>Niveli i lartë</p>	<p>Në përfundim të klasës së 12-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të analizojë anët e forta dhe të dobta në lidhje me aftësitë sipërmarrëse; ▪ të analizojë dëshirën dhe mundësitë për realizimin e një veprimtarie sipërmarrëse.

OBJEKTIVAT E NDARA SIPAS 3 NIVELEVE TË ARRITJES SË NXËNËSVE		
LINJA 3		PLANIFIKIMI/ VENDIM MARRJA PËR KARRIERËN
<p>Linja 3: Për objektivat e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet letërkërkesës; - të hartojë një “curriculum vitae” sipas formateve të qarta dhe konsistente, me gjuhë të qarta dhe duke vënë në dukje (në formë imagjinare), aftësitë, cilësitë personale; 	Niveli bazë	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë rastet e përdorimit të kërkesës për punë; ▪ të shpjegojë rëndësinë dhe rregullat e hartimit të “curriculum vitae”;
	Niveli i mesëm	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të plotësojë një format të gatshëm të kërkesës për punë; ▪ të hartojë një format të thjeshtë të “curriculum vitae”.
	Niveli i lartë	<p>Në përfundim të klasës së 11-të nxënës/i-ja:</p> <p>Ëtë plotësojë formate të ndryshme të kërkesës për punë sipas llojit; Ëtë hartojë një “curriculum vitae” sipas kërkesave standarde, duke imagjinuar një punë konkrete.</p>

a) Si të hartojmë objektivat specifike në tri nivele^{1*}?

Struktura e një objektivi përbëhet nga:

¹ Kjo pjesë është marrë nga materiali i përgatitur nga grupi i specialistëve pranë QKTA-së në vitin 2007.

Veprimtaria tregon atë që shfaq nxënësi për të paraqitur arritjet e tij: “përshkruan”, “identifikon”, “liston”, “mbledh”, “ndërton”, “harton”, “lidh”, “përmend”, “përsërit”, “shkruan”, “diskuton”, “përfshihet”, “respekton”, “analizon” etj.

Objekti mësimor (shkurt “objekt”), tregon termat, konceptet, shkaqet, pasojat, krahasimet, lidhjet, emrat, datat, modelet, faktet, burimet historike, personazhet historikë, etj, që shqyrtohen në programin e lëndës, mbi të cilat bien veprimtaritë e nxënësve.

Objekti + Veprimtaria = Objektiv

Shembull 1: Nxënës/i/ja harton + kërkesën për punë.

Veprimtaria = harton

Objekti = kërkesën për punë

Pjesë të një objektivit, përveç veprimtarisë dhe objektit, janë dhe kushti e kriteri/ standardi:

Kushti dhe kriteri plotësojnë dhe saktësojnë objektivin në përmbushjen e qëllimit të tij.

Kushtet bëjnë të mundur kryerjen e veprimtarisë për realizimin e objektivit (mjedisi, mjetet, pajisjet, materialet ndihmëse apo koha që nxënësi duhet të ketë në dispozicion për realizimin e objektivit).

Kriteret përdoren për të vlerësuar, krahasuar atë që nxënësi shfaq gjatë paraqitjes së arritjes së veprimtarisë së parashikuar në objektiv. Kriteri mund të mos shkruhet kur nënkuptohet, por nuk mund të shmanget kur është fjala për modalitetet e vlerësimit. Kështu, për shembull, vlerësimi që përdoret kur mësuesi do të nxjerrë notën përfundimtare të nxënësit është i bazuar në “kriteret”, d.m.th. në nivelin e arritjeve që demonstroi nxënësi, në raport me objektivat e programit, ose në raport me standardet.

b) Nivelet e arritjeve të objektivave:

- *Niveli bazë*
- *Niveli mesatar*
- *Niveli i lartë*

Përsa i përket hierarkisë së arritjeve të nxënësve, ne do të ruajmë terminologjinë e përkthuar të standardet: niveli bazë (më i ulëti) i arritjeve, niveli mesatar dhe niveli i lartë.

Po t'i referohemi klasifikimit të Blumit për nivelet e njohjes, atëherë, për objektivat e ndryshëm të programeve do të gjenim se:

- nëse nxënësi *duhet të japë përkufizimin* e një koncepti, ky objektivi është i nivelit bazë (në nivelin 1);
- nëse nxënësi *shpjegon me fjalët e tij*, kjo është e nivelit bazë (në nivelin 2);
- nëse nxënësi *vendos ngjarjet në shkallën e kohës*, kjo është e nivelit mesatar;
- nëse nxënësi *argumenton një çështje*, kjo përfshin ndoshta të gjitha nivelet, deri te më i larti.

c) Formulimi i objektivave specifike.

Objektivat specifike – paraqesin në mënyre të matshme veprimtarinë e nxënësit.

Kur hartohen objektivat specifike (për objekte të caktuara mësimore), arritja treguese bëhet e përcaktuar plotësisht, madje tani tregohen edhe kushtet në të cilat ajo pritët të shfaqet, si dhe kriteret e saktësisë së përmbushjes (plotësimi) të arritjes së synuar. Objektivat specifike hartohen nga mësuesit.

Për të formuluar qartë një *objektiv specifik*, mund të ndjekim hapat e mëposhtëm:

- Shkruaj veprimtarinë e vëzhguar (sjelljen). Do të thotë se duhet të shkruhet ajo që nxënësi duhet të jetë i aftë të realizojë për të provuar se e ka arritur objektivin. Ky është një rregull i detyrueshëm.
- Shkruaj kushtet në të cilat duhet të manifestohet veprimtaria (sjellja). Saktësimi i këtyre kushteve lejon që objektivi të përcaktohet më mirë, që të sqarohen kufijtë e tij.
- Saktëso kriterin e arritjes (paraqitjes). *Shembuj kriteresh* janë: koha e kryerjes, përqindja e përgjigjeve të mira etj.

Kur formulon një objektiv specifik, pasi përcakton se cilit nivel shkollimi i përket ai (kjo në rastin tonë është e zgjidhur nga programi), duhet t'u përgjigjesh edhe pyetjeve të mëposhtme:

1. Cila është veprimtaria e vëzhguar që do të tregojë se objektivi është arritur?
2. Cili do të jetë objekti (produkti) i kësaj veprimtarie (arritjeje)?
3. Në cilat kushte do të realizohet veprimtaria?
4. Cilat kritere/standarde do të shërbejnë për të përcaktuar nëse veprimtaria është realizuar dhe sa mirë është realizuar ?

SHEMBULL 1 : *Të hartojë planin e karrierës në mënyrë të pavarur sipas udhëzimeve dhe formatit të dhënë;*

- **Veprimtaria e vëzhguar (çfarë ?):** të hartojë
- **Objekti (Kë?):** planin e karrierës
- **Kushti (Ku?):** në mënyrë të pavarur (në klasë apo shtëpi)

- **Kriteri (Si? Sa?): (sipas udhëzimeve dhe formatit të dhënë)**

2. Metodologjia dhe mjetet mësimore për zhvillimin e lëndës “Edukimi për karrierën”

Ka disa teori për zhvillimin e karrierës dhe marrjen e vendimeve, po paraqesim dy më kryesoret *teorinë strukturore* dhe *atë zhvillimore*, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e strategjive të edukimit për karrierën.

- *Teoritë strukturore* fokusohen në përputhjen e karakteristikave të individit me profesione që shkrijnë interesat dhe prirjet e individit. Bazuar në këto teori individi duke njohur qartë aftësitë, interesat, mundësitë, kufizimet që zotëron hulumton mundësitë për të ardhmen bazuar në kushtet e tij. Referuar teorive strukturore shohim prirjen e zhvillimit të karrierës dhe vendimarrjes nëpërmjet përputhjes së të tipologjisë së personalitetit të individit me profesionet. Kjo teori i klasifikon njerëzit në gjashte kategori të personaliteteve dhe mjediseve profesionale.
 - Kategoria e *realistëve*, që preferojnë të punojnë me sende, vegla por jo me njerëz. Tipikë për këtë grup janë zanatçinjtë apo p.sh. inxhinierët.
 - Kategoria e *hulumtuesve*, që preferojnë të përdorin arsyetimin, inteligjencën në punë si përpunim të dhënash, punë kërkimore. Ky grup nuk preferon të punojë me sende. Shembull, janë shkencëtarët e fushave të ndryshme.
 - *Artistik*, përfshin kategorinë e njerëzve që janë krijuar, me

intuitë të zhvilluar. Ky grup punon me mjete dhe vegla por edhe me njerëz. Tipikë të këtij grupi janë artizanët, artistët.

- **Socialë**, përfshin një grup që preferon të punojë me njerëz dhe jo me sende si psh, punonjësit socialë, mësuesit etj.
- Kategoria e **sipërmarrësve**, që përfshin njerëz që kanë aftësi të drejtojnë dhe bindur të tjerët në fushën e politikës, financiare, të biznesit etj.
- **Konvencionalë**, janë njerëz që merren me të dhëna si kontabilistët, financierët etj.
- **Teoritë zhvillimore** e shohin karrierën si proces zhvillimi, pra, në varësi të fazave, përvojave që individi kalon, ai merr vendime. Këto teori fokusohen në faktin që njerëzit ndryshojnë dhe si rrjedhojë ata mund të përshtaten në një numër profesione, mbajtur parasysh dhe faktin që çdo profesion kërkon një kompleksitet aftësish.

Objektivat e programit mbajnë parasysh të dyja këto teori. Mësuesit nëpërmjet veprimtarive konkrete duhet të nxisin nxënësit të identifikojnë dhe klasifikojnë aftësitë dhe dijet e tyre, të drejtojnë nxënësit për të hulumtuar në botën e punës me qëllim përzgjedhjen e profesioneve që përputhen me cilësitë e tyre dhe njëkohësisht të kuptojnë se njerëzit me kohë dhe nga përvojat në punë ndryshojnë.

Drejtimi nëpërmjet modelimit, këshillimi janë strategjitë kryesore që mësuesi duhet të përdorë deri sa nxënësi të bëjë sipërmarrjen e tij për të ardhmen.

Mbajtur parasysh orientimin praktik të kësaj lënde arritja e misionit të saj kërkon angazhimin serioz dhe marrjen e përgjegjësive nga të gjithë aktorët jo vetëm në shkollë por dhe jashtë saj.

Përgjegjësia e nxënësve, prindërve, mësuesve, drejtorive të shkollave orientohet dhe fokusohet për arritjen e objektivave të lëndës si më poshtë:

Nxënësit kanë përgjegjësinë kryesore në procesin e tyre të të nxënit. Ata bëhen më të motivuar nëse gjatë të nxënit zbulojnë lidhjen mes përpjekjeve të investuara dhe arritjeve.

Për shkak të sfidave të shumta që ka procesi i shkollimit, ka nxënës që e gjejnë të vështirë marrjen e përgjegjësive për të nxënë të tyre si rrjedhojë vëmendja, durimi dhe inkurajimi nga ana e mësuesve merr rëndësi për suksesin e tyre.

Zhvillimi koncepteve dhe aftësive në edukimin për karrierë kërkon një konsensus për të punuar, mësuar dhe zhvilluar shprehitë e përshtatshme jo vetëm në klasë por veçanërisht jashtë saj.

Studimet tregojnë se nxënësit performojnë më mirë nëse **prindërit** e tyre janë përfshirë në arsimimin e tyre.

Duke u familjarizuar me programin e edukimit për karrierën, prindërit mund të kuptojnë më mirë se çfarë mësohet në shkollë dhe çfarë pritët nga fëmijët e tyre për lëndën përkatëse.

Njohja e pritshmërive nga fusha e studimit i ndihmon prindërit në interpretimin e komenteve të mësuesve në lidhje me ecurinë e fëmijëve të tyre dhe në punën e tyre për përmirësimin e nxënies së nxënësve.

Edukimi për karrierë promovon të nxënit gjatë gjithë jetës. Prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në eksplorimin e mundësive më të përshtatshme për qëllime të zhvillimit të karrierës, përmes një përfshirje më të madhe në aktivitete të ndryshme në komunitet.

Mësuesit dhe nxënësit kanë përgjegjësi komplementare. Mësuesit kanë për detyrë të zhvillojnë strategjitë e përshtatshme të mësimdhënies më qëllim që të stimulojnë nxënësit në arritjen e pritshmërive të programit, në zhvillimin e metodave të përshtatshme të vlerësimit të arritjeve të nxënësve.

Mësuesit mbështesin nxënësit në zhvillimin e kompetencave kyçe të tilla si: leximin, shkrimin, komunikimin verbal, dhe aftësitë numerike të nevojshme për sukses në zhvillimin e këtij programi.

Mësuesit sjellin entuziazëm dhe variacion të përfaqësive të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve në klasë, duke adresuar nevoja të ndryshme të nxënësve dhe siguruar mundësi të forta të nxënies për çdo nxënës. Duke përdorur një varietet të strategjive të mësimdhënies dhe vlerësimit të nxënësve, mësuesit sigurojnë mundësi të shumta të nxënësit për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe investiguese, të aftësive ndërpersonale duke përfshirë këtu aftësitë komunikuese (verbale dhe me shkrim), si dhe aftësitë për manaxhimin personal, si dhe për t'u orientuar në tregun e punës. Mundësitë për të lidhur këto aftësi dhe koncepte me jetën reale e bëjnë procesin e të nxënësit më kuptimplotë për nxënësit dhe i motivojnë ata për të nxënë gjatë gjithë jetës.

Mësuesit duhet të:

- Vënë theksin te konceptet, teoritë, marrëdhëniet, idetë dhe përgjithësimet;
- T'i krijojnë mundësi nxënësve të shprehën lirshëm në një shumëllojshmëri mënyrash, duke përfshirë të shkruarin krijues, prezantimin, apo duke hyrë në veprime praktike për tematika të ndryshme;
- T'i angazhojë nxënësit në projekte të pavarura;
- T'i inkurajojë nxënësit në një shkallë të gjerë veprimtarish praktike

të cilat do t'i krijojnë atyre mundësinë të hyjnë në kontakte me njerëz në “botën reale” dhe të vëzhgojnë praktikat ditore që mundësojnë suksesin.

Drejtorët e shkollave punojnë në bashkëpunim me mësuesit dhe prindërit për të siguruar që çdo nxënës të përftojë përvojën më të mirë të mundshme mësimore. Përveç kësaj, drejtuesit mbështesin dhe inkurajojnë bashkëpunimin mes shkollës dhe komunitetit me qëllim lehtësimin e mundësive për të nxënësit nëpërmjet përvojave profesionale në komunitet, shumë të nevojshme për zhvillimin e edukimit për karrierën. Gjithashtu, drejtoritë sigurojnë që të gjitha burimet e nevojshme, janë në dispozicion të mësuesve dhe nxënësve si dhe lehtësojnë pjesëmarrjen e mësuesve në programe për zhvillimin e tyre profesional.

Në lëndën “Edukimi për karrierën”, nxënësi zhvillon aftësitë e nevojshme për të kërkuar informacion në lidhje me mundësitë për të nxënë dhe për të punuar. Nxënësit aftësohen të krijojnë lidhje ndërmjet këtyre mundësive dhe qëllimeve personale të karrierës. Ata mësojnë rreth tendencave të vendeve të punës, në një ekonomi globale dhe lokale, si dhe në shoqëri. Gjithashtu nxënësit mësojnë përfitimet që vijnë nga zotërimi i një rangu të gjerë të aftësive të cilat lehtësojnë përshtatjen me kërkesat e një tregu global në ndryshim të vazhdueshëm. Ata zhvillojnë njohuri, aftësi dhe strategji të cilat zbusin tranzicionin midis stadeve dhe roleve të ndryshme në jetë. Ata përgatisin veten për të nxënësit e vazhdueshëm pas të mesëm dhe për sfidat e krijimit dhe gjetjes së mundësive për punë.

Me qëllim sigurimin e një vlerësimi të vlefshëm dhe të besueshëm të nxënësve, me qëllim përmirësimin e procesit të të nxënësit, ***mësuesit rekomandohet të përdorin strategji*** të cilat:

- Adresojnë jo vetëm se çfarë nxënësit nxënë por edhe se sa mirë ata nxënë;

- Bazohen në kriteret e performancës;
- Janë të përshtatshme me aktivitetet e të nxënësve, qëllimin e mësimit dhe nevojat dhe përvojat e vetë nxënësve;
- Janë të paanëshme;
- Sigurojnë feedback të qartë të nxënësve dhe prindërve;
- Promovojnë aftësitë e nxënësve për t'u vetëvlerësuar.

Nxënësve mësojnë mirë kur bëhen pjesë e një varieteti mënyrash për të nxënë, duke stimuluar aftësitë kërkimore, të menduarin kritik, frymën e bashkëpunimit, diskutimet për çështje të ndryshme si dhe të nxënësve përmes praktikës. Disa nga strategjitë e mësimdhënies të cilat konsiderohen të përshtatshme në këtë linjë përfshijnë punën në grup për tematika të ndryshme, të nxënësve të orientuar, reflektimet personale, lojën me role, analizat e rasteve studimore, prezantimet, realizimin e detyrave të cilat përfshijnë paraqitjen e materialeve të vërtetë nga vendi i punës, të nxënësve praktik dhe studimin e pavarur. Mësuesit duhet të sigurojnë një tërësi veprimtarish dhe detyrash të cilat mundësojnë zotërimin e koncepteve bazë dhe zhvillimin e aftësive investiguese/kërkimore.

Të nxënësve praktik si një nga metodat kyçe të mësimdhënies, ka të bëjë me nxënien e përfutur plotësisht apo pjesërisht përmes përvojave praktike brenda apo jashtë klasës. Këtu përfshijmë intervistat për mbledhje informacioni, eksperiencat pune të stimuluar apo virtuale, vizitat në vende pune. Të tilla përvoja do të ndikojnë në drejtimin që nxënësve do ndjekin për eksplorimin e karrierës dhe planifikimin e tyre akademik.

Teknologjia e informacionit dhe komunikimit ofron një tërësi instrumentesh të cilat lehtësojnë dhe pasurojnë strategjitë mësimdhënëse të mësuesit. Kështu, TIK mund të përdoret për të lidhur nxënësve me shkollat të tjera, brenda dhe jashtë vendit. Përmes faqeve të internetit

dhe CD-ROM, nxënësit mund të hyjnë në burime të cilat sigurojnë informacion të aktualizuar mbi tregun e punës, statistika dhe tendenca, të dhëna profesionale, informacion nga agjenci të specializuara si dhe informacione të tjera për eksplorimin e mundësive për të nxënë dhe zhvilluar karrierën. Megjithëse interneti konsiderohet si një instrument i fuqishëm, të gjithë nxënësit duhet të jenë të kujdesshëm ndaj çështjeve të sigurisë, përgjegjshmërisë në përdorim si dhe në lidhje me mënyrën e përdorimit sa më efektiv të tij.

Veprimtaritë e rekomanduara mësimore për zhvillimin e objektivave të linjës “Hulumtimi i karrierës” përmbledhen si më poshtë:

Nr	Aktivitete mësimore/Burime	Shembuj të objektivave mësimore në programin e lëndës
1.	<ul style="list-style-type: none"> - Leksion, dhënia e informacioneve të mjaftueshme për konceptet bazë. - Nxitja e diskutimeve për të bërë dallimet midis punës, profesionit dhe karrierës, përmes ilustrimit me shembuj nga jeta. - Zhvillimi i lojërave me role lidhur me punë, profesione të ndryshme (p.sh. profesioni i sekretares: mbajta e regjistrimeve, daktilografimi nëse është i mundur etj.) - Intervistimi i prindërve apo të afërmeve për punën që kryejnë dhe më pas raportimi në klasë për gjetjet (vihet theksi në teknikat e intervistimit). - Prezantime të historive të suksesshme për ndikimin e kualifikimit dhe përvojës profesionale në zhvillimin e karrierës nga të ftuar të ndryshëm. 	<p>Nxënës/i/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të argumentojë me shembuj lidhjet dhe ndryshimet midis punës, profesionit dhe karrierës; - të shpjegojë kuptimin dhe rëndësinë e kualifikimit në përgjithësi dhe atij profesional, në lidhje me statusin e punësimit; - të shpjegojë sistemin formal, informal, joformal të kualifikimit në Shqipëri; - të diskutojë ndikimin e kualifikimit në zhvillimin e karrierës.

	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i llojeve të ndryshme të materialeve audio-vizuale. - Prezantimi i individëve të ndryshëm nga komuniteti për të folur rreth punëve të tyre. - Vizita të mbikëqyrura në institucione të ndryshme të arsimit dhe formimit profesional. - Vizita të mbikëqyrura në universitete dhe ndërmarrje të ndryshme që ofrojnë programe trajnimi. - Zhvillimi i projekteve për të krahasuar shumëllojshmërinë e mundësive për të nxënë pas shkollës së mesme (p.sh. çirakëria, universiteti, niveli pas të mesëm dhe parauniversitar, trajnimi nëpërmjet punës, arsimit në distancë) dhe identifikuar ato që konsiderohen të jenë në harmoni me interesat, pritshmërinë dhe kompetencat. - Intervista me mësues dhe instruktorë të qendrave të arsimit dhe formimit profesional. 	
<p>2.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vizita në institucione që mundësojnë zbatimin e legjislacionit të punës. - Nxitja e diskutimeve për të paraqitur ndikimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e punësimit, përmes ilustrimit me shembuj nga bota e punës. - Raste studimore. - Investigimi dhe prezantimi i shembujve konkretë të zbatimit apo mos zbatimit të legjislacionit të punës në organizata të ndryshme. - Vizita në kompani dhe intervista për të vëzhguar dhe eksploruar kushtet e punës dhe rolin e tyre lidhur me rreziqet dhe përgjegjësitë për ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor në punë. 	<ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë legjislacionin e punës në lidhje me kushtet e punës, kohën e lejuar të punës, pushimet, të drejtat dhe detyrimet e palëve në punë; - të paraqesë shembuj të zbatimit të legjislacionit të punës në veprimtari pune; - të shpjegojë rëndësinë e rregullave të sigurimit në punë dhe mbrojtjes së mjedisit; - të paraqesë raste të rreziqeve dhe të sigurisë në veprimtari të e punës .

<p>3.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Studime individuale apo mikro kërkime në tregun lokal të punës. - Gjenerimi i diskutimeve. - Raste studimore. - Vizita të mbikëqyrura në kompani të ndryshme për të parë konkretisht si punohet në punë të ndryshme brenda kompanisë, duke iu krijuar mundësi të bisedojnë me punonjës që punojnë në punë për të cilat ata kanë interes. - Vizita të mbikëqyrura në zyra punësimi publike dhe private për t'u njohur me shërbimet kryesore që ofrohen në to, duke iu krijuar mundësi të bisedojnë me punonjësit. - Vizita të mbikëqyrura në institucione qendrore politikë-bërëse për t'u njohur me politikat kryesore në fushën e punësimin dhe përkrahjes sociale. - Projekt investigimi mbi prirjet e punësimit duke marrë në konsideratë globalizimin, zhvillimet 	<ul style="list-style-type: none"> - të paraqesë prirjet e zhvillimit të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar ; - të paraqesë burimet kryesore të punësimit në tregun lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar të punësimit; - të identifikojë shërbimet kryesore sociale dhe zyrat e punësimit në tregun lokal; - të shpjegojë statusin e individëve në tregun e punës (i punësuar, i papunë, student etj); - të listojë forma të ndryshme të ndihmës për të papunët; - të paraqesë shërbimet që ofrojnë zyrat e punësimit dhe ndihmës sociale në tregun lokal. - të paraqesë veprimtaritë ekonomike .
<p>4.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - në TIK, rolet në ndryshim të organizatave të punëdhënësve dhe sindikatave, ndryshimet demografike etj). - Nxitja e diskutimeve për të bërë dallimin mes formave të ndryshme të punësimit, duke ilustruar me shembuj konkretë. - Raste studimore. - Prezantime nga të ftuar të historive të suksesshme për ndikimin e kualifikimit dhe përvojës profesionale në zhvillimin e karrierës. - Projekt për identifikimin e mundësive rajonale dhe lokale për punësim, duke përfshirë vetëpunësimin dhe sipërmarrjen, duke përdorur burime të ndryshme, si: internet, vizita, folës të ftuar, zyrat e punësimit etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë profesionet që lidhen me veprimtaritë e shërbimit dhe ato të prodhimit në tregun lokal; - të argumentojë ndryshimet midis veprimtarive të ndryshme të punës; - të vlerësojë ndikimin e profesioneve të ndryshme në organizimin e jetës së përditshme; - të paraqesë përvoja nga pjesëtarët e familjes në lidhje me ndikimin e profesionit në mënyrën e jetesës. - të identifikojë rëndësinë e formave të ndryshme të punës duke përfshirë punën në familje, punën vullnetare, në komunitet;

5.	<ul style="list-style-type: none"> - Studime individuale apo mikro kërkime përmes përdorimit të burimeve të ndryshme të informacionit, si p.sh. një rrjet personal komunikimi, zyrat e punësimit, njoftime on-line në internet etj, për vende të lira pune. - Diskutime - Detyrë projekt në grup në aplikimin e metodave të ndryshme për të kërkuar punë 	<ul style="list-style-type: none"> - të interpretojë informacionin nga burime të ndryshme për vende të lira pune. - të shpjegojë metoda të ndryshme për të.
6.	<p>Nxjtja e diskutimeve për të bërë dallimin ndërmjet njohurive, aftësive dhe qëndrimeve, duke ilustruar me shembuj konkretë</p> <ul style="list-style-type: none"> -Inkurajimi i leximit të pavarur të biografive të personave profesionalisht të suksesshëm në jetë. -Inkurajimi i nxënësve për të marrë informacion përmes ngritjes së urave të komunikimit me individë që rezultojnë të suksesshëm në fushën profesionale për të cilën interesohen. -Mundësimi i pjesëmarrjes së nxënësve në konferenca ku trajtohen çështje të karrierës. -Raste studimore. -Raportimi mbi profesionet e përzgjedhura , duke përdorur informacionet e mbledhura nga intervistat (p.sh. duke shfrytëzuar e-mail, takimet ballë për ballë apo nëpërmjet telefonit) si dhe nga vizitat studimore, teknikat e simulimit, informacionet e internetit etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - të paraqesë shembuj të njohurive, aftësive, qëndrimeve në profesione të ndryshme; - të hetojë karriera të ndryshme në tregun virtual dhe real të punës nëpërmjet instrumenteve të caktuara; - të listojë profesione të investiguara nga tregu punës; - të paraqesë profesionet e preferuara nga investigimi; - të paraqesë argumentet mbi përzgjedhjen e profesioneve të preferuara.

7.	<ul style="list-style-type: none"> - Gjenerim diskutimesh - Prezantim i individëve të ndryshëm nga komuniteti për të folur rreth punëve të tyre. - Raste studimore. - Zhvillimi i lojës me role për profesionet e përzgjedhura. - Vizita të mbikëqyrura në institucione të ndryshme të arsimit dhe formimit profesional. - Vizita të mbikëqyrura në universitete dhe ndërmarrje të ndryshme që ofrojnë programe formimi. - Proces hulumtimi për të lokalizuar informacionin mbi mundësitë e kualifikimit dhe të punës lidhur me karrierën që paraqet interes (P.sh. programet formale të shkollimit, kurset e formimit profesional, mundësitë për eksperiencë profesionale etj). -Vizita në kompani të ndryshme për të parë konkretisht se si punohet në profesionet e përzgjedhura, duke iu krijuar mundësi të bisedojnë me punonjës që punojnë në punë për të cilat ata kanë interes. 	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë njohuritë, aftësitë, qëndrimet në profesionet e përzgjedhura; - të identifikojë kualifikimet e nevojshme për profesionet e përzgjedhura; - të tregojë nëpërmjet shembujve ndikimin e përvojave të ndryshme të punës, trajnimeve në karriera të ndryshme; - të hetojë në vendin e punës tri profesione të përzgjedhura; - të hartojë instrumentet e hulumtimit sipas formateve të përcaktuara dhe njësuara nga mësuesi; - të paraqesë rezultatet e hulumtimit.
----	---	--

Veprimtaritë e rekomanduara mësimore për zhvillimin e objektivave të linjës “Vetëvlerësimi” përmbledhen si më poshtë:

Nr	Aktivitete mësimore/Burime	Shembuj të objektivave mësimore në programin e lëndës
1.	<ul style="list-style-type: none"> - Skicimi i një prezantimi për vehten me renditje progresive sipas një modeli të dhënë nga mësuesi; - Dhënia e punëve të pavarura për të vetëvlerësuar arritjet, prirjet dhe aftësitë; - Prezantimi nga nxënësit sipas një formati të caktuar i prirjeve dhe aftësive personale dhe argumentimi i tyre; - Prezantimi dhe argumentimi i interesave dhe dëshirave personale në një format të caktuar. - Nxitja e diskutimeve në lidhje me prirjet dhe profesionet e përzgjedhura; - Grumbullimi dhe analiza nga nxënësi i imazheve (karakteristikave) të njerëzve në punë ; - Nxitja e veprimtarive për të identifikuar fushat e mundëshme të karrierës bazuar në prirjet, dëshirat, familjen, mundësitë etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - të identifikojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme; - të argumentojë interesat dhe dëshirat personale për profesione të ndryshme; - të bëjë vetëvlerësimin duke mbajtur parasysh dëshirat dhe interesat që lidhen me profesione të ndryshme.
2.	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi harton, prezanton dhe argumenton sipas një formati të përcaktuar synime në lidhje me karrierën duke rishikuar, reflektuar për progresin dhe arritjet e tij. - Nxënësi përdor vetëvlerësimet dhe pyetësorët në lidhje me karrierën në ndihmë të përcaktimit të objektivave afatshkurtër dhe afatmesëm, lidhur me profesionet dhe targetet e të mësuarit. 	

<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi harton, prezanton dhe argumenton sipas një formati të përcaktuar objektiva afatshkurtra dhe afatmesme për karrierën - paraqitja sipas një formati të përcaktuar e synimeve të karrierës, prezantimi dhe argumentimi i këtyre synimeve; - Vlerësimi i shëndetit sipas një formati të caktuar duke iu referuar cilësive të kërkuara për profesionet e përzgjedhura; - Paraqitja sipas një formati të përcaktuar dhe prezantimi i shembujve të ndikimit që kanë medikamentet, duhani, alkooli, droga për profesionet e përzgjedhura. - Grumbullimi sipas një formati dhe analiza e imazheve (karakteristikave) të njerëzve në punë në profesionet e përzgjedhura; - Nxitja e debatit mbi këndvështrimet në lidhje me punët e burrave dhe punët e grave; - Nxënësi bën regjistrime dhe komente mbi atë se si eksperiencat e punës, komunikimi, etika etj, kanë ndihmuar në mundësitë e punësimit; - Nxënësi nxitet të shkruajë të dhëna të pasqyruara nga eksperiencia e punës së tyre; - Mësuesi nxit nxënësit të identifikojnë dhe rishikojnë reagimet mbi ndikimet dhe presionet e tilla si ato të medias, moshatarëve, shokëve dhe kushërinjve; 	<ul style="list-style-type: none"> - Të vlerësojë/rivlerësojë aftësitë dhe prirjet personale të nevojshme në lidhje me profesionet e përzgjedhura; - të vlerësojë shëndetin personal (ndikimin edhe të medikamenteve, drogave, alkoolit) në lidhje me profesionet e përzgjedhura; - të paraqesë rezultatet e vlerësimit në lidhje me shëndetin personal; - të paraqesë shembuj nga realiteti lidhur me ndikimet e përdorimit në punë të medikamenteve, duhanit, alkoolit, drogës; - të vlerësojë ndikimin e rolit gjinor në profesionet e përzgjedhura; - të paraqesë shembuj nga realiteti lidhur me ndikimet e rolit gjinor në tregun e punës; - të identifikojë aspekte të sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionet e përzgjedhura; - të paraqesë nëpërmjet shembujve ndikimin e sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionet e përzgjedhura; - të shpjegojë me shembuj rëndësinë e komunikimit, veshjes, paraqitjes, sjelljes në mjediset e punës;- të identifikojë tipare, faktorë që ndikojnë në karriera të suksesshme; - të shpjegojë me shembuj si ndikojnë vendim-marrja, menaxhimi i kohës, stresi, konfliktet, planifikimi etj, në suksesin në karrierë; - të listojë tiparet personale për të patur karrierë të suksesshme në profesione të përzgjedhura. - të vlerësojë profesionet e përzgjedhura duke bërë dallimin mes objektivitetit dhe paragjykit
---	---

	<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi identifikon cilësitë e kurseve më të larta të shkollimit, aftësitë që fitohen nga këto shkollime dhe analizon dhe ballafaqon këto me planet e karrierës së tyre; - Identifikon mundësitë për kualifikim të mëtejshëm, për të rritur perspektivën e karrierës. 	
--	--	--

Veprimtaritë e rekomanduara mësimore për zhvillimin e objektivave të linjës “Vendimarrja/Planifikimi i karrierës” përmbledhen si më poshtë:

Nr	Aktivitete mësimore/Burime	Shembuj të objektivave mësimore në programin e lëndës
1.	<ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi paraqet te nxënësit rrugët dhe mënyrat e kërkimit, aplikimit për punë si dhe mënyrat e dokumentet që nevojiten për të kërkuar dhe aplikuar për punë; - Nxënësi organizon dhe prezanton informacionin personal në formatin e dhënë; - Nxënësi përgatit një kalendar aplikimesh pune dhe plan veprimi; - Nxënësi hulumton procedurat e aplikimit për shkollimin dhe punën si dhe ushtrohet në mënyrë praktike për dhënien e përgjigjeve të ndryshme; - Nxënësi harton sipas modeleve të dhëna CV-në dhe përgatit prezantim personal me fjalë, letër aplikimi; - Nxënësi përgatit një listë të plotë intervistash; - Mësuesi nëpërmjet veprimtarive të ndryshme praktikon nxënësit të japin përgjigje për pyetje të vështira; 	<p>Nxënës/i/ja duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet letërkërkesës; - të hartojë kërkesën për punë nëpërmjet telefonit; - të hartojë kërkesën për punë në formë elektronike; - të plotësojë forma të gatshme aplikimi për punë; - të hartojë një “curriculum vitae” sipas formateve të qarta dhe të qëndrueshme, me gjuhë të qartë duke vënë në dukje (në formë imagjinare), aftësitë, cilësitë personale; - të shpjegojë llojet e intervistave për punë; - të shpjegojë hapat e përgatitjes për intervistën e punës (parapërgatitja, intervista, reflektimi);

<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi sipas formateve të pëcaktuara si dhe në mënyrë të mbikqyrur nga mësuesi, përdor analiza mbi vendet e lira dhe të zëna të punës si dhe përzgjedh informacionin për të identifikuar informacionin e duhur si dhe për të bërë përgatitjet për një aplikim; - Mësuesi drejton nxënësin që nëpërmjet veprimtarive të ndryshme të ndjekë procedurat e aplikimit në mënyrë korrekte duke përdorur një sërë teknikash të prezantimit personal sipas qëllimit të dhënë; - Nxënësi vlerëson paraqitjen dhe efektivitetin e tij sipas një formati të caktuar; - Nxënësi përgatit një plan të strukturuar veprimi për të kapërcyer dobësitë e identifikuara; - Nxënësi përgatit dhe kryen një interviste të imituar pune; - Nxënësi përdor një netëork personal të aftësive lidhur me organizimin dhe intervistën; - Nxënësi prezanton mirë veten në intervistat e simuluar duke paraqitur aspekte të vendimmarrjes; - Nxënësi diskuton dhe përgatit marketingun e aftësive personale në nivelin e duhur. 	<ul style="list-style-type: none"> - të paraqesë procesin e parapërgatitjes për intervistë; - të paraqesë rregullat e komunikimit dhe etikën gjatë intervistës; - të paraqesë reflektimin në lidhje me intervistën; - të paraqesë në një rast të simuluar interviste.
<p>2.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mësuesi shpjegon dhe jep shembuj në lidhje me hapat për planifikimin dhe marrjen e vendimit për karrierën; - Mësuesi prezanton përmbajtjen dhe mënyrat e mbajtjes së portofolit të karrierës; - Nxënësi nën mbikqyrjen e mësuesit përdor një teknikë të hapur vendimmarrje duke përcaktuar: Çfarë është e rëndësishme? Cilat janë zgjedhjet? Cilat janë pasojat?; 	<ul style="list-style-type: none"> - të shpjegojë procesin e planifikimit të karrierës; - të analizojë informacionin e mbledhur për të arritur në vendimmarrje; - të shpjegojë procesin e vendimmarrjes për karrierën; - të hartojë qëllimin dhe objektivat për karrierën; - të planifikojë afatet kohore për çdo objektivi për karrierën;

<ul style="list-style-type: none"> - Nxënësi gjatë planifikimit përdor ndihmën dhe këshillat nga burime të ndryshme si: prindërit, njerëz me përvojë pozitive në fushën karrierës, mësuesit etj; - Gjatë procesit të planifikimit dhe vendimarrjes nxënësi studion raste të ish nxënësve që kanë mbaruar shkollën; - Mësuesi shpjegon, paraqet mënyra të gjetjes dhe llogaritjes së buxheteve; - Nën mbikqyrjen e mësuesit nxënësi bën llogaritje të buxheteve (bazë) - Nxënësi investigon burimet financiare për të mbështetur shkollimin apo trajnimin e mëtejshëm. - Nën mbikqyrjen e mësuesit nxënësi krijon dhe mirëmban portofolin e planifikimit të karrierës duke u fokusuar në ndikimet e ndryshimeve personale, shoqërore dhe ekonomike si dhe identifikon anë të forta dhe të dobëta si dhe përgatit një listë me hapat e veprimeve në të ardhmen; - Nëpërmjet veprimtarive të ndryshme nxënësi identifikon kriteret për të vendosur se çfarë dhe kur do të studioj në arsimin e lartë; - Identifikon detyrimet financiare për shkollën e lartë. 	<ul style="list-style-type: none"> - të planifikojë buxhetin personal lidhur me karrierën; - të planifikojë strategjitë për karrierën personale; - të listojë elementet përbërës të portofolit për karrierën; - të plotësojë portofolin për karrierën sipas rubrikave, të paraqesë nëpërmjet shembujve ndikimin e sensualitetit, seksualitetit, intimitetit në raport me profesionet e përzgjedhura; - të shpjegojë me shembuj rëndësinë e komunikimit, veshjes, paraqitjes dhe sjelljes në mjediset e punës; - të identifikojë tipare, faktorë që ndikojnë në karriera të suksesshme; - të shpjegojë me shembuj si ndikojnë vendimarrja, menaxhimi i kohës, stresi, konfliktet, planifikimi etj, në suksesin e karrierës; - të listojë tiparet personale për të patur karrierë të suksesshme në profesione të përzgjedhura; - të vlerësojë profesionet e përzgjedhura duke bërë dallimin mes objektivitetit dhe paragjykimit.
---	---

- **Shembuj të detyrave në lidhje me veprimtarinë që i referohet:
Vlerave në punë**

Mësuesi shpjegon rëndësinë që ka për individin baraspeshimi në përgjithësi i vlerave të punës me kënaqësitë e individit. Nxënësit duhet të kuptojnë dhe të drejtohen që përzgjedhjen për karrierën ta bazojnë në cilësitë e tyre.

A. Nëpërmjet kësaj flete pune nxënësit gjykojnë për cilësitë e tyre. Listo 2 nga vlerat e tua të punës (kjo përzgjedhje bëhet pasi nxënësit i parashtrohet një listë prej 20 vlerash)

Cilësitë	Cilësitë e mia	Puna e përzgjedhur bazuar në këto cilësi
1. Personalitet		
2. Entuziazëm		
3. Besueshmëri		
4. Paraqitja		
5. Aftësi/qëndrime/vlera		
6. Inteligjencë		
7. <i>Cilësi të tjera</i>		

B. Listo 3 profesionet që përshtaten më shumë me vlerat e tua të punës:

1.
.....
2.
.....
3.
.....

C. Dallo nëse një nga 3 profesionet ka përshtatshmëri më të mirë me ty dhe argumento pse?

D. Dallo nëse një nga 3 profesionet përshtatet me interesat e tua?

E. Diskutoni me prindërit për vlerat e tyre të punës. Ndryshimi i vlerave të punës gjatë viteve.

- **Shembuj të detyrave në lidhje me veprimtarinë që i referohet:
Llojit të personalitetit**

Mësuesi duhet të shpjegojë kuptimin dhe llojet e personalitetit të individit. Po japim disa veprimtari në lidhje me këtë rubrikë.

A. Imagjinoni sikur sapo keni arritur në një festë, gjatë kësaj feste dëgjon biseda të ndryshme. Dalloni bisedën që është me interesante për ty? Përcaktoni tipin e personalitetit që ka grupi që ju pëlqen të bashkoheni.

B. Zgjidh një person dhe përshkruaj tipin e tij të personalitetit bazuar në karakteristikat e tij individuale.

C. Bazuar në tipin tuaj të personalitetit listo grupet e karrierës që ju përshtaten më shumë.

D. Më poshtë janë paraqitur disa profesione, bazuar në karakteristikat e secilit profesion, bëni zgjedhjen tuaj.

Lloji i detyrës	Mjek	Fermer	Elektriçist	Zgjedhja juaj
Manuale				
Kërkimore				
Social				
Influencues				
Artistik				
Konvencionalë				

- **Shembuj të detyrave në lidhje me veprimtarinë që i referohet: grupeve të e karrierës që u interesojnë më shumë**

Mësuesi shpjegon kuptimin në lidhje me aftësitë “aftësia për të kryer një punë apo detyrë/ për të bërë diçka mirë”. Ndoshta gjatë periudhës së shkollimit individi nuk e ka mundësinë për të shfaqur këtë aftësi por kjo gjatë përvojave të jetës mund të transferohet (pjesë të njohurive akademike transferohen në aftësi). Gjithnjë e më shumë punëmarrësit kërkojnë të punësojnë persona që shfaqin aftësi reale.

A. Vlerëso aftësitë e tua

Vlerëso aftësitë e tua	Si e renditni aftësinë
<p><i>Aftësitë e komunikimit</i>.....Gjeni lehtë mënyrën për të thënë çfarë mendoni? Jeni të aftë të shpjegoni?.....</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	
<p><i>Fleksibiliteti</i>..... Jeni ju të aftë të ndërroni planet në minutën e fundit? Merrni parasysh këndvështrimet e të tjerëve?</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	
<p><i>Aftësitë e drejtuesit</i>.....Ju shohin të tjerët si person për të bërë apo thënë diçka në emër të tyre? Jeni ju të aftë të udhëhiqni grupin për të arritur një qëllim të caktuar?.....</p> <p>.....</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	
<p><i>Aftësi për të zgjidhur probleme</i>.....Jeni ju i aftë të zgjidhni një problem nëpërmjet një konkluzioni logjik?</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	

<p><i>Nismëtar</i>..... Jeni ju i aftë të studioni në mënyrë të pavarur pa qenë i mbikqyrur? Jeni ju i vetëmotivuar? Jeni ju i aftë të planifikoni dhe organizimin e studimeve tuaja?.....</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	
<p><i>Social</i>..... Jeni ju i aftë të bashkëpunoni me të tjerë? Integroheni mirë me të tjerët?.....</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	
<p><i>Aftësi për të punuar në grup</i>.....Jeni ju pjesëmarrës në grupe pune? A ndikojnë pasionet e tua (edhe sportet) të përfshihen më mirë në punët në grup? Keni kënaqësi të ndihmoni të tjerët për të përmbushur një detyrë?.....</p> <p>Jepni shembuj të përvojave tuaja</p> <p>...</p>	

MODEL MESIMI

TEMA: Veprimtaria e një personi sipërmarrës

PËRSHKRIM:

Nxënësit do moderohen të listojnë karakteristikat që lidhen me një sipërmarrës, të cilat do të përdoren për të dhënë përkufizimin e

një sipërmarrësi. Bazuar në këtë përkufizim nxënësit do të jenë të aftë të identifikojnë një sipërmarrës si dhe të bëjnë dallimin e një personi sipërmarrës në botën e biznesit.

KONCEPTET:

Sipërmarrës, sipërmarrje, sipërmarrje sociale, sipërmarrje biznesi

OBJEKTIVAT:

Në përfundim të kësaj teme nxënësit do të jenë të aftë:

- të përcaktojnë termin sipërmarrës, sipërmarrje;
- të identifikojnë persona sipërmarrës bazuar në tiparet e tyre dalluese;
- të dallojnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe sipërmarrjes sociale;
- të analizojnë veçoritë e 2-3 sipërmarrësve lokal dhe të përshkruajnë veçoritë e biznesit të tyre.

KUSHTET/MATERIALET MBËSHTETËSE:

Artikuj gazetash, revistash me histori sipërmarrjesh/sipërmarrësish, fletë intervistash për personat sipërmarrës, modele detyrash për të listuar, evidentuar dhe dalluar veçoritë e sipërmarrësve.

KOHA E KERKUAR: 1 ose 2 orë mesimore

HAPAT:

Veprimtaria 1

Mësuesi prezanton konceptin e sipërmarrjes dhe parashtrohet një përcaktim/përkufizim të thjeshtë. Më pas mësuesi shkruan në tabelë një pohim të hapur: *pronari i një biznesi është.....*

Nxënësve u jepet një ose dy minuta kohë për të sjellë ide dhe mendime mbi pohimin dhe të krijojnë një listë me sugjerime që ata ndjejnë se duhet për të plotësuar këtë pohim. Përgjigjet duhet të shkruhen në tabele

dhe të krijohet një listë përmbledhëse. Nxënësit duhet të shkruajnë në fletore këtë listë, e cila do të shërbejë për të realizuar veprimtarinë e dytë.

Veprimtaria 2

Mesuësi i shpërndan nxënësve shkrime të ndryshme ose histori mbi sipërmarrësit dhe sipërmarrjen dhe pasi ata i lexojnë këto histori, mund të drejtojnë pyetjet e mëposhtme:

- Cili është kuptimi mbi sipërmarrjen?
- Cili është përkufizimi për një sipërmarrës?
- Çfarë cilësish ka një sipërmarrës biznesi?
- Çfarë cilësish ka një sipërmarrës social?
- Cili është stili i jetës së një sipërmarrësi?
- Cili është dallimi mes një sipërmarrësi dhe një personi jo sipërmarrës?

Shënim: Historitë mbi sipërmarrësit dhe sipërmarrjen mund të zgjidhen nga mësuesi, nëse do të ishte e mundur mbi sipërmarrësit/sipërmarrjen lokale, por që të përmbajnë material, për të cilat të jepen/gjenden përgjigjet e pyetjeve të mësipërme.

Veprimtaria 3

Mësuesi diskuton me nxënësit përkufizimet e dhëna dhe qartëson përcaktimin e saktë të tyre.(dhënë në veprimtarinë e dytë)

Më pas u jep nxënësve të lexojnë një histori të një sipërmarrësi lokal, duke u dhënë kohën e nevojshme për lexim. Historia e dhënë duhet të jetë e tillë që të përmbajë problemet që do të shërbëjnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mëposhtme. Mësuesi mund të shtojë ose të heqë pyetje në varësi të historisë së dhënë ose nëse e sheh të arsyeshme edhe në varësi të nivelit të klasës.

Pas leximit të historisë u drejton nxënësve pyetjet e mëposhtme:

- Cila qe arsyeja që *(emri i sipërmarrësit)* filloi biznesin në fushën e *(produkti që ai prodhon)?*
- Si i lindi kjo ide?
- Cili ishte rreziku që ai mori përsipër?
- Si mendoi që ta kalonte këtë rrezik?
- Cilat janë dy arsye që e bëjnë *(emri i sipërmarrësit)* sipërmarrës?
- Shumë sipërmarrës kontribuojnë në ndihmë të komunitetet ku jetojnë: a ka bërë *(emri i sipërmarrësit)* diçka për komunitetin?
- A përputhet eksperiencia dhe cilësitë *(emri i sipërmarrësit)* me përcaktimin mbi sipërmarrësin?

VLERËSIM (KONTROLL)

1. Në hapësirën më poshtë përcakto me fjalët e tua karakteristikat e një sipërmarrësi.
2. Listo 3 karakteristika të një personi sipërmarrës
3. Argumento dallimin midis sipërmarrësit dhe personit jo sipërmarrës.
4. Evidentoni dallimin midis sipërmarrësit social dhe sipërmarrësit të biznesit.

DETYRË SHTËPIE

Nxënësit përgatisin në shtëpi një listë me pyetje për të intervistuar një sipërmarrës. Mësuesi duhet të miratojë dhe njëhsojë listën me pyetjet e tyre. Sugjerohet që lista për intervistim të jetë e njejtë me qëllim lehtësimin e diskutimit dhe vlerësimit të nxënësve.

Nxënësit duhet të planifikojnë kohën dhe mënyrën për të realizuar intervistën me një sipërmarrës.

Pas kryerjes së intervistës nxënësit duhet të shkruajnë një ese të shkurtër mbi sipërmarrësin. Eseja duhet të përmbajë karakteristikat që sipërmarrësi ka shfaqur si dhe çështje apo veçori të tjera.

3. Vlerësimi i nxënësit

Vlerësimi i nxënësit është gjykimi mbi arritjen e nxënësit, krahasuar kjo me kriteret apo standardet e kërkuara nga programi.

Vlerësimi është një proces që përshkon gjithë procesin mësimor dhe qëndron në themel të të nxënësve. Vlerësimi i nxënësit është një përgjegjësi e rëndësishme dhe kërkon të mbështetet në parametra bashkëkohorë.

Veprimtaria vlerësuese është tepër komplekse, ajo duhet integruar në tërësinë e veprimtarisë mësimore. Në mësimdhënien dhe mësimnxënien e lëndës së edukimit për karrierën *qëllimet e vlerësimit* do të ishin:

- të bëhet përforsimi i vazhdueshëm në kujtesën e nxënësve i njohurive dhe koncepteve;
- të zhvillohen te nxënësit aftësitë dhe prirjet për të bërë punë të pavarur, për të operuar me informacionin, për ta përdorur atë në situata konkrete;
- të njohë nxënësit me rezultatet e të nxënësve për t'i ndihmuar ata të përmirësojnë të nxënësve e mëtejshëm;

- të ndihmojë në përpunimin, kategorizimin dhe kodimin e njohurive historike, me qëllim ruajtjen e tyre në kujtesë për një afat sa më të gjatë;
- të aftësojë nxënësit për të krahasuar njohuritë e tyre të përfutuara gjatë procesit të të nxënit, me standardet dhe objektivat e pritshëm të lëndës;
- të motivojë nxënësit për arritje dhe tregues më të suksesshëm;
- t'i japë mësuesit informacion për nivelin e dijeve të nxënësit, për arritjet dhe boshllëqet, me qëllim që mbi këtë bazë ai jo vetëm bën vlerësimin e tyre, por merr dhe masa për të luftuar dobësitë, për ta bërë mësimin sa më të suksesshëm.

Në kushtet e reja të mësimdhënies së edukimit për karrierën, ku punohet me standarde e objektiva lëndorë, strategji e metoda të reja, nuk duhet të përdoren kritere dhe metoda të vjetra vlerësimi, të cilat kultivojnë të riprodhuarit mekanik të përmbajtjeve.

Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi është një proces i cili kalon në tri etapa kryesore :

- **Kontrolli**, kupton procesin e kërkimit dhe të mbledhjes së informacionit në lidhje me orientimin për karrierën, me qëllim që të nxirren përfundime për nivelin e të mësuarit dhe të nxënit. Kontrolli i njohurive, shprehive dhe aftësive të nxënësve në këtë lëndë është disa llojesh: paraprak, i vijueshëm, periodik dhe përfundimtar. Ai realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si: teknikat e të pyeturit, prezantimit, punë krijuese, si: hartim referatesh, esesh, intervista, vëzhgime, hartim grafikësh, tabelash etj.

- **Matja** është një proces krahasimi, krahasohet sasia e informacionit të njohur me sasinë e informacionit të panjohur

në raport me njohuritë që duhet të përvetësojë nxënësi sipas objektivave të programit. Kur bëjmë matjen e njohurive, nxënësve u duhet të analizojnë argumente, dëshmi, të krahasojnë koncepte, dukuri, fakte, të diskutojnë, të debatojnë, të argumentojnë dhe të parashikojnë, duke mbajtur qëndrim personal ndaj një ngjarjeje apo figure të caktuar historike. Matja mund të shprehet me pikë, me përqindje ose me një evidencë të thjeshtë etj., krahasuar me një standard apo objektiv të programit lëndor.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes, që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe shprehitë, por edhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike-sociale, në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore dhe të vendosë nota në regjistër për secilën orë mësimore. Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm, si partnerë, rreth përvetësimit të njohurive të fituara në orët e kaluara dhe kryerjes mirë të detyrave jashtë klase.

Herë pas here mësuesi duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve që në fillim qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Mësuesi vlerëson me notë apo me stimul shkallën dhe dinamikën e pjesëmarrjes së nxënësve në procesin mësimor. **Mësuesi, gjithashtu, vlerëson saktësinë e informacionit të paraqitur nga nxënësi, aftësinë e tij për të diskutuar, debatuar, krahasuar, argumentuar dhe parashikuar, duke mbajtur qëndrimin e tij personal ndaj çështjeve që diskutohen. Në këtë lëndë mësuesi duhet të vlerësojë aftësinë e nxënësve për të punuar në grup dhe për të vlerësuar nga secili nxënës punën e anëtarëve të tjerë të grupit.**

Mësuesi duhet të vlerësojë **përdorimin e burimeve alternative nga nxënësit**, ballafaqimin e tyre dhe forcën argumentuese ndaj një çështjeje të diskutueshme ose të debatueshme. Kriter vlerësimi për nxënësit është dhe përfshirja e tyre në debat, duke respektuar mendimet e kundërta të të tjerëve, të bazuara mbi argumente ose fakte.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënësi vlerësohet me notë, ndërsa paraqet arritjet e tij me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarish e produktesh të tjera, si: veprimtari praktike, raste studimore, shkrimi i një eseje, prodhimi i një CD-je etj. Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënësi në veçanti.

Portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare, tabelë kronologjike, CD, dokumentar mbi një karrierë, postera, albume, ese, artikuj publicistikë etj.

Portofoli i përngjet një albumi me anën e të cilit mësuesi, nxënësi vetë dhe prindërit e tij gjejnë informacion të shpejtë dhe të sintetizuar rreth progresit të nxënësit. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësuesi rekomandon.

Nisur nga qëllimi i realizimit, vlerësimi mund të klasifikohet në vlerësim formues, diagnostikues, përmbledhës, motivues.

Vlerësimi formues, synon marrjen e informacionit mbi atë që ka arritur të përvetësojë nxënësi krahasuar me standardin mësimor. Ky informacion i nevojitet mësuesit për të ndërhyrë dhe ndryshuar mësimdhënien duke siguruar kalimin në objektiva të rinj mësimore vetëm pasi të jenë arritur objektivat mësimorë paraprakë. Vlerësimi formues ndihmon jo vetëm mësuesin në planifikimin e orës së mësimi, por dhe nxënësin në identifikimin e atyre koncepteve të cilat kërkojnë

një punë të mëtejshme për t'u përvetësuar.

Vlerësimi diagnostikues, përdoret për aspekte të përvetësimit të njohurive nga nxënësit, për të gjykuar për atë që kanë mësuar dhe nuk kanë mësuar nxënësit. Ky tip vlerësimi përdoret për të marrë informacion mbi përgatitjen dhe dobësitë e nxënësve në përvetësimin e materialit mësimor, me qëllim që mësuesi të marrë masa për të plotësuar këto dobësi të nxënësve.

Vlerësimi motivues, ka për qëllim të nxisë interesin dhe dëshirën e nxënësve për efikasitetin e të nxënit duke ndihmuar në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies. Ai përbën një ndër format më efektive që mund të përdoret në drejtim të nxitjes së të mësuarit tek nxënësit. Kur përcaktohen objektiva të qartë dhe të saktë nga mësuesit për njësi ore mësimore, nxënësi është në gjendje t'i shohë dhe t'i masë vetë arritjet e i tij, duke nxitur në këtë mënyrë dëshirën e tij për më shumë përparim.

Vlerësimi përmbledhës, bëhet në përputhje me objektivat mësimore në fund të semestrit, vitit ose në fund të studimit të disa kapitujve mësimorë. Ai jep informacion mbi atë çfarë kanë arritur të nxënë dhe të bëjnë nxënësit gjatë periudhës së dhënë kohore; është mirë të parashikohen disa vlerësime përmbledhëse gjatë vitit.

Vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve bëhet përmes një numri të madh *teknikash vlerësimi*. Ato janë:

1. Vlerësimi me shkrim (testet);
2. Vlerësimi gojor;
4. Vlerësimi me listë kontrolli i projekteve, punëve të pavarura, punëve në terren etj.

Është e këshillueshme që informacioni mbi shkallën e nxënies së nxënësve të merret sipas rastit duke përdorur secilën nga teknikat e mësipërme.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e komunikimit me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike.

Mësuesi planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore të cilat i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet e shkurtra, pakminutëshe për një objektiv të veçantë të të nxënësve, tek ato njëorëshe; teste me alternativë ose me zhvillim; detyra tematike, projekte kurrikulare etj. Një formë e parashtrimit me shkrim nga nxënësit është dhe provimi përfundimtar.

Mësuesi e vlerëson nxënësve me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij, të zhvilluara vetë ose në grup.

Për kurrikulën-bërthamë nxënësve vlerësohet me notat 4-10. Në përfundim të semestrit të parë, për secilin nxënës dhe lëndë përlogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore.

Mbajtur parasysh karakterin praktik të lëndës “Edukimi për karrierën”, sugjerohet të përdoret vlerësimi me portofol, që mund të korespondojë me portofolin e karrierës që ka çdo nxënës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

UDHËZUES KURRIKULAR
(MATERIAL NDIHMËS PËR MËSUESIT E GJIMNAZIT)

LËNDA: KARRIERA DHE AFTËSITË PËR JETËN
(Aftësitë për jetën)

KLASA 11^{të} dhe 12^{të}

TIRANË, 2010

PJESA 1: RËNDËSIA E LËNDËS AFTËSI PËR JETËN NË KURRIKULËN E RE TË GJIMNAZIT

Aftësitë për jetën janë një grup kompetencash psiko-sociale dhe ndërvetjake që i ndihmojnë nxënësit të marrin vendime të mirinformuara, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyrë të efektshme, të ndërtojnë marrëdhënie të shëndetshme intelektuale dhe emocionale me të tjerët, si dhe të ndërtojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurt.

1.1 SYNIMET E KURRIKULËS SË RE

Programi i lëndës aftësi për jetën synon:

Të përgatitë nxënësit për të zhvilluar një mënyrë jetese aktive, të frytshme, të shëndetshme dhe të sigurt; që të përzgjedhin dhe të zbatojnë sjellje që parandalojnë sëmundje, dobësi dhe rreziqe të ndryshme për vete dhe për të tjerët; që ata të bëhen veprimtarë aktivë në sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm e bashkëpunues.

Programi i aftësive për jetën është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare. Ai është hartuar mbështetur në dokumentet kryesore si, korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës ku kjo lëndë bën pjesë.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së gjimnazit.
- Synimeve të linjave ndërkurrikulare.
- Vlerësimit të nxënësit.
- Parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënës dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e

barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare.

Çdo standard i fushës në këtë dokument përmban një seri linjash dhe standarde të linjave.

Linjat janë drejtime në të cilat përmbushet standardi.

Standardi i linjës është një pohim specifik që tregon atë që nxënësit duhet të dinë dhe të jenë të aftë të bëjnë në një drejtim të caktuar specifik të standardit të përgjithshëm. Standardet e linjës shërbejnë për të matur progresin e nxënësve drejt arritjes së standardit të përgjithshëm. Sikurse dhe standardi i përgjithshëm, edhe standardi i linjës është përcaktuar për në fund të gjimnazit.

Për çdo standard linje, janë vendosur një seri objektivash arritjeje.

Objektivat e arritjeve janë pohime të njohurive, aftësive, qëndrimeve që nxënësi demonstroi në përpjekjen për të arritur standardin e linjës.

Në kuadrin e kësaj lënde zhvillohet dhe linja e edukimit shëndetësor, e cila synon:

Të zhvillojë te nxënësit njohuri dhe aftësi mbi dimensionet e shëndetit (mirëqenies) fizik, social, emocional dhe intelektual, në mënyrë që t'u krijojë atyre mundësi për të bërë zgjedhje të drejta rreth shëndetit të tyre, tani e në të ardhmen. Mirëqenia përcaktohet si një mënyrë jetese, që thekson masat mbështetëse që tregojnë kujdes për mirëqenien e shëndetit, të tilla si: eksplorimi i ndjenjave të tyre, që do të zhvillojë respektin për vetveten dhe do të realizojë besimin në arritjet e tyre. Kjo do t'i ndihmojë ata të menaxhojnë ndjenjat dhe emocionet e tyre si dhe përgatitjen për të përballuar streset; për përdorimin e substancave të ligjshme dhe të paligjshme; për një të ushqyer të shëndetshëm; proceset e riprodhimit njerëzor dhe të problemeve të abuzimit seksual.

Kryesore në këtë edukim është aftësimi i nxënësve për të siguruar informacione në lidhje me shëndetin, institucionet të cilave mund t'u drejtohet në rast nevojë dhe krijimi i ndjenjës së kontrollit dhe të mundësive për arritjen dhe afirmimin e suksesit.

Konceptet në kurrikulën e re

Programi i edukimit shëndetësor për klasën e 10-të të gjimnazit është organizuar me grup temash apo nënlinja. Për çdo nënlinjë shënohen

objektivat, të cilat materializojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që pritet të nxënë nxënësit gjatë këtij kursi.

Kurrikula e edukimit shëndetësor organizohet në gjashtë **nënlinja**:

1. Shëndeti
2. Të ushqyerit e shëndetshëm
3. Alkooli dhe drogat e tjera
4. Barnat (ilaçet)
5. Seksualiteti
6. Edukimi mbi HIV-SIDËN

Në kurrikulën e re të aftësive për jetën në linjën e edukimit shëndetësor për klasën e 10-të nxënësit do të thellojnë njohuritë, aftësitë, qëndrimet në konceptet për **shëndetin**. Dijet që nxënësit kanë marrë tashmë në arsimin e detyruar në të gjitha lëndët dhe në mënyrë të veçantë në atë të biologjisë, që këto koncepte i ka të integruara, do të *zgjerojnë dhe thellojnë njohuritë, aftësitë e qëndrimet* pwr:

- dimensionet e shëndetit (mirëqenies fizike, sociale, emocionale dhe intelektuale); për sjelljet dhe faktorët e rrezikshëm për shëndetin;
- faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut (trashëgimia dhe prirja e lindur ndaj disa sëmundjeve etj.);
- ndikimin në shëndetin e tyre e stereotipave, si: gjumi, higjiena, stresi marrëdhëniet sociale, familjare dhe komunitare;
- përgjegjësinë që ka individi për shëndetin e tij (kryerja e analizave periodike më të domosdoshme etj);
- sëmundjet më të zakonshme tek adoleshentët;
- zbulimin dhe përpunimin e informacionit të nevojshëm shëndetësor në mënyrë që të ndër marrë veprime për të mbrojtur shëndetin e tij dhe të tjerëve si dhe të kërkojë ndihmë të specializuar në rast nevojë.

Mbështetur në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që nxënësit kanë mësuar në arsimin e detyruar për probelemtë e një të **ushqyerit të shëndetshëm**, në klasën e 10-të do t'i thellojnë këto në:

- marrëdhënien ndërmjet ushqimit dhe shëndetit;
- vlerësimin të të ushqyerit e shëndetshëm si një nevojë për një zhvillim mendor optimal dhe një aktivitet shkollor maksimal;
- faktorët që ndikojnë në shprehjet tona të të ushqyerit;

- nevojën për kalori për grupmoshat e ndryshme dhe për njerëzit e profesioneve të ndryshme;
- argumentimin pse është e shëndetshme një dietë e varfër në lyra të ngopura, në sheqer e në kripë;
- hartimin një plan ushqyerje për një të ri të shëndetshëm, duke konsideruar dietën e balancuar, rekomandimin e mënyra të shëndetshme për të humbur, për të fituar ose për të mbajtur peshën etj.

Ndërsa përmes nënlinjës për **alkoolin** dhe drogat e tjera nxënësit do të fitojnë e thellojnë njohuritë, aftësitë e qëndrimet për të kuptuar:

- se përdorimi i duhanit është një shkaktar i sëmundjeve të: kancerit, zemrës, emfizemës etj.;
- ndikimin e alkoolit dhe drogave të tjera në ato zona të trurit të cilat kontrollojnë kujtesën, të parët, gjumin, koordinimin dhe kohën e reagimit dhe aksidenteve automobilistike;
- lidhjen midis përdorimit të drogave me injeksion dhe sëmundjeve si SIDA dhe Hepatiti B;
- lidhjen midis përdorimit të alkoolit, e drogave të tjera dhe incidenteve të përdhunimit, SST dhe shtatzanisë së padëshiruar;
- të ndihmojë personat që janë përdorues të substancave abuzive.

Përmes nënlinjës për **barnat**, e cila trajtohet për herë të parë në kurrikulën tonë, nxënësit do të fitojnë njohuri, aftësi e qëndrime:

- që të vlerësojnë efektivitetin e një bari duke marrë parasysh dozat, efektet anësore, mënyrat e marrjes dhe përfitimet kundrejt rreziqeve;
- për përdorimin e barnave të reja ose eksperimentale dhe të diskutojnë rreziqet dhe përfitimet;
- për përfitimet dhe rreziqet e barnave nga bimët mjekësore;
- të lexojnë për të kuptuar përshkrimin e një medikamenti etj.

Ndërsa në nënlinjën **seksualiteti** do të fitojnë e thellojnë njohuritë, aftësitë e qëndrimet:

- për të dalluar seksualitetin nga seksi, zhvillimin seksual gjatë cikleve të ndryshme të jetës;
- për të vlerësuarë presionet e brendshme dhe të jashtme për t'u bërë

seksualisht aktivë dhe për të paraqitur strategji për t'u rezistuar presioneve;

- për prirjet e përqindjeve të shtatzënisë të adoleshenteve dhe lindjet në adoleshencë duke përqendruar vëmendjen në modelet martesore, normat seksuale, praktikat kontraceptive, vlefshmërinë e abortit dhe raportin e lartë të numrit të adoleshentëve ndaj numrit të popullsisë;
- për të hulumtuar çështje të shëndetit riprodhues dhe seksual te femra dhe meshkujt dhe të diskutojnë rëndësinë e edukimit shëndetësor parandalues (p.sh. të bërit nga gratë e testeve të gjoksit dhe mitrës dhe e testikujve nga burrat, për problemet tumorale,) etj.

Edhe pse për problemet e **edukimit mbi HIV/SIDË-n**, në arsimin e detyruar, nxënësit kanë fituar njohuri të konsiderueshme, është parë e arsyeshme që ata në gjimnaz t'i thellojnë njohuritë, të zhvillojnë aftësitë dhe qëndrimet, duke patur në konsideratë se kjo grup moshe është më aktive seksualisht.

Objektivat e arritjeve për këtë nënlinjë janë konceptuar që të përfshijnë një gamë prej katër njësisish që janë:

1. Njohuritë bazë mbi HIV/ SIDË-n dhe SST.
2. Sjelljet e përgjegjshme: vonimi i marrëdhënieve seksuale.
3. Sjelljet e përgjegjshme: marrëdhëniet seksuale me mjete mbrojtëse.
4. Kujdesi dhe mbështetja e njerëzve të sëmurë nga HIV/ SIDA.

1.2 ZHVILLIMI I AFTËSIVE

Kurrikula e gjimnazit në përgjithësi dhe ajo e aftësisë për jetën në veçanti, përshkohet nga disa linja ndërkurrikulare.

Këto linja ndërkurrikulare ndahen në tri grupime: të përmbajtjes, të të menduarit dhe të qëndrimit.

Linjat ndërkurrikulare të përmbajtjes janë: teknologjia e informacionit dhe e komunikimit dhe komunikimi.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit

Secili nxënës të bëhet i aftë që lehtësisht dhe në mënyrë organike,

në çfarëdo situatë që i paraqitet në lëndën e aftësisë për jetën:

- të kërkojë e të gjejë informacion elektronik;
- të hetojë, të bëjë parashikime dhe të zgjidhë situata problemore me ndihmën e mjeteve elektronike;
- të paraqesë e prezantojë punën e tij duke përdorur një larmi mediash dixhitale;
- të bashkëpunojë me bashkënxënësit nëpërmjet komunikimit elektronik.

Komunikimi: nxënësit ushtrohen të komunikojnë me shkrim të zakonshëm, me anën e figurave ose të përdorin mjete të ndryshme të komunikimit, përfshirë dhe ato shumwmediatike.

Katër format e komunikimit janë: me të folur, me të dëgjuar, me lexim, me shkrim.

E folura

Secili të bëhet i aftë t'ua transmetojë me gojë të tjerëve informacione, ide, ndjenja dhe imazhe në mënyrë të saktë, të qartë, të plotë, të mirëstrukturuar dhe bindëse, duke përdorur: *një fjalor gjithnjë e më të pasur dhe mënyrën më të përshtatshme për një audiençë të caktuar dhe situatë të caktuar.*

E dëgjuara

Secili të bëhet i aftë:

- të jetë dëgjues i vëmendshëm;
- të veçojë qartë paqartësitë që i dalin nga dëgjimi i parashtrimeve të të tjerëve;
- t'i bëjë pyetje folësit për paqartësitë e tij;
- t'i bëjë komente rreth parashtrimeve të të tjerëve.

Të lexuarit

Secili të bëhet i aftë:

- të lexojë me shpejtësinë dhe saktësinë e mjaftueshme për të kuptuar një tekst;
- të veçojë qartë moskuptimet që i dalin gjatë leximit;
- të përdorë strategji të larmishme dhe të përshtatshme për të kuptuar, përdorur dhe reflektuar mbi një tekst të shkruar.

Të shkruarit

Secili të bëhet i aftë t'u transmetojë me shkrim të tjerëve informacione, ide, ndjenja dhe imazhe në mënyrë të saktë, të qartë, të plotë, të mirëstrukturuar dhe bindëse, duke përdorur: *një fjalor gjithnjë e më të pasur; larmi mënyrash të parashtrimeve me shkrim si dhe mënyrën më të përshtatshme të komunikimit me shkrim për lexues të caktuar dhe situatë të caktuar.*

Linjat ndërkurrikulare të të menduarit janë:

- menaxhimi i informacionit;
- zgjidhja e situatave problemore;
- të menduarit kritik;
- të menduarit krijues.

Të gjitha këto linja janë të ndërlidhura dhe formojnë, në të vërtetë, një unitet që ka të bëjë me standardet intelektuale.

Menaxhimi i informacionit

Si në të gjitha fushat e të nxënës, edhe në lëndën e aftësisë për jetën, mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të stërvitet në kërkimin dhe përpunimin e informacionit, i cili i nevojitet që të përmbushë një detyrë të ndërmarrë nga ai vetë ose të ngarkuar nga të tjerë. (Detyra mund të jetë një pyetje deri në një projekt kompleks)

Secili të bëhet i aftë:

- të kërkojë në burime të larmishme informacioni për të përmbushur një detyrë;
- të pikasë burimin ose burimet më të përshtatshme të informacionit për të përmbushur një detyrë;
- të përdorë strategji të larmishme për të analizuar informacionin;
- të përdorë strategji të larmishme për të përpunuar informacionin;
- të vlerësojë informacionet nga pikëpamja e dobisë për detyrën dhe e vërtetësisë;
- të përdorë strategji të larmishme për të integruar informacionet nga burime të ndryshme;
- të veçojë me kthjelltësi çfarë kupton nga çka nuk kupton në informacionin që përpunon dhe të formulojë pyetjet për të qartësuar të kuptuarit;

- të përdorë strategji të larmishme për të nxjerrë shënimet e nevojshme nga informacioni i qëmtuar;
- të ruajë informacionin me mënyra të larmishme;
- të prezantojë informacionin e përpunuar me anën e një larmie formash dhe mjetesh.

Zgjidhja e situatave problemore

Të zgjidhësh një situatë problemore, do të thotë të përdorësh njohuritë e fituara tanimë, për të zgjidhur një problem në një situatë të pahasur më parë nga personi që merret me zgjidhjen.

Secili të bëhet i aftë:

- të analizojë një situatë problemore;
- të hartojë një plan për zgjidhjen duke e ndarë një detyrë në nën-detyra;
- të veçojë sistematikisht paqartësitë e të formulojë pyetje për to;
- të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e etapave të zgjidhjes problemore;
- të përdorë strategji të larmishme si, analogjinë, induksionin, etj.;
- të justifikojë në mënyrë bindëse metodën ose metodat e përdorura të kërkimit dhe të arritjes së përfundimeve;
- të bëjë parashikime, të ngrejë hipoteza;
- të mbrojë ose hedhë poshtë parashikimet ose hipotezat me prova të mjaftueshme;
- të hetojë lidhjet “shkak-pasojë”;
- të kërkojë e gjejë zgjidhje të ndryshme;
- të vlerësojë rrugën e zgjidhjes për ta përmirësuar atë.

Të menduarit kritik (të menduarit analitik)

Në përdorimin e përditshëm, termi “kritik” ka ngjyresën e një qëndrimi mosmiratues, kurse këtu, në të vërtetë, është fjala për të menduarit analitik. Si e tillë, kritika përfshin analizën, sintezën dhe vlerësimin si procese mendore tipike.

Të menduarit kritik është një strategji e cila funksionon mirë kur duhet të përballemi me një situatë problemore ose të marrim një vendim.

Procesi i të menduarit kritik përmban grumbullimin e informacionit të nevojshëm, vlerësimin e tij dhe arritjen në një përfundim të argumentuar mirë.

Pjesë e rëndësishme e të menduarit kritik është kujdesi i posaçëm dhe i përhershëm ndaj paragjykimeve vetiake ose të të tjerëve, anësisë, keqinformimit.

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të kultivojë të menduarit kritik (analitik) ndaj informacioneve, ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve.

Secili të bëhet i aftë:

- të shqyrtojë mundësi të ndryshme “pro” dhe “kundër” për një çështje të caktuar;
- të dallojë faktet nga interpretimet e tyre;
- të mbajë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj gjykimeve dhe qëndrimeve të të tjerëve;
- të mbajë qëndrim të pavarur dhe argumentues ndaj informacioneve në përgjithësi dhe atyre mediatike në veçanti;
- të jetë i vemendshëm ndaj argumenteve të të tjerëve dhe të mos u kundërvihet me paragjykime;
- të sjellë argumente dhe dëshmi për të mbështetur përfundimet, përgjithësimet dhe bindjet e tij;

Të menduarit krijues

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të shfaqë origjinalitetin e tij dhe të zhvillojë prirjet e veta krijuese.

Secili të bëhet i aftë:

- të shprehë nëpërmjet një larmie formash anët origjinale të personalitetit të tij në shkollë, komunitet dhe punë;
- të kërkojë për ide e rrugëzgjdhje të reja;
- të mirëpresë ide dhe përvoja të reja të të tjerëve;
- të sipërmarrë me kurajë plane ambicioze duke analizuar shanset dhe marrë në sy rreziqet.

Linjat ndërkurrikulare të qëndrimit janë: qëndrimi etiko-social, qëndrimet gjatë punës në grup.

Qëndrimi etiko-social

Përtej njohurive dhe aftësive dhe nëpërmjet tyre, edhe lënda aftësi

për jetën synon një ndikim të fortë në formimin e karakterit të nxënësve, duke u përqendruar posaçërisht në rrënjësjet e qëndrimeve, vlerave dhe bindjeve vetjake. Gama e tyre është shumë e gjerë dhe përfshin, ndër të tjera, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të nxënësve në veçanti, pra, edhe mospranimin dhe mosushtrimin e çfarëdo lloji diskriminimi, respektimin e vlerave, madje zhvillimin e tyre, mbrojtjen e mjedisit në të gjithë larminë e tij etj.

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të ushtrohet për të mbajtur qëndrime etiko-sociale ndaj ngjarjeve, dukurive dhe qëndrimeve. Secili të bëhet i aftë:

- të vlerësojë dukuritë, ngjarjet, qëndrimet dhe veprimet e të tjerëve në të shkuarën dhe në të tashmen nga pikëvështrimi i dobisë sociale për komunitetin, vendin, rajonin dhe më gjerë;
- të jetë pjesëmarrës aktiv i veprimtarive dhe i lëvizjeve të cilat synojnë përmirësime në shkallë komuniteti, vendi, rajoni dhe më gjerë.

Qëndrimi gjatë punës në grup

Mësuesit duhet t'i japin mundësinë secilit nxënës që të përvetësojë qëndrimet e përshtatshme për punë të suksesshme në grup.

Secili të bëhet i aftë:

- të mbajë përgjegjësi ndaj suksesit të grupit të punës në tërësi;
- të respektojë rregullat e grupit të punës ku pranon të marrë pjesë;
- të jetë bashkëpunues me pjesëtarët e tjerë të një grupi pune;
- t'u përshtatet roleve të ndryshme brenda grupit;
- të sillet me respekt ndaj pjesëtarëve të tjerë të një grupi pune;
- të respektojë pikëpamjet e ndryshme të anëtarëve të grupit.

Në programin e ri të aftësive për jetën shprehen në mënyrë të dukshme **aftësitë, shprehitë dhe qëndrimet**, duke vënë theksin te rezultatet e të nxënësve.

Mësuesit duhet të organizojnë mësimdhënien në mënyrë të tillë që nxënësit të zhvillojnë aftësitë dhe qëndrimet, si: ato të të pyeturit, të krahasuarit, të renditurit, përpunimi i rezultateve, lidhja shkak-pasojë, parashikimi, komunikimi, hipoteza, interpretimi i të dhënave, lidhja e

shkencës me jetën e përditshme, interesat, puna në grup etj.

Të mësosh nxënësit që të mendojnë në mënyrë kritike do të thotë:

- T'i mësosh ata si të pyesin, kur të pyesin dhe çfarë pyetjesh të bëjnë.
- T'i mësosh si të arsyetojnë, kur ta përdorin arsyetimin dhe çfarë metodash arsyetimi të përdorin.

Nxënësi mund të mendojë në mënyrë kritike dhe arsyetuese vetëm në masën sa është në gjendje të shqyrtojë me kujdes përvojat, të vlerësojë njohuritë dhe idetë dhe pastaj të peshojë argumentet përpara sesa të arrijë në një gjykim të baraspeshuar. Të jesh mendimtar kritik, përfshin, gjithashtu, zhvillimin e disa qëndrimeve të caktuara, si për shembull dëshira për të arsyetuar, vullneti për të sfiduar dhe pasioni për të vërtetën.

Tipari dallues i të mendurit kritik është *gadishmëria për të sfiduar idetë e të tjerëve*. Një rrjedhim i kësaj është që nxënësi duhet të jetë gjithashtu i gatshëm që edhe idetë e veta t'ia nënshtrojë shqyrtimit të imët dhe sfidës së arsyetimit. Kur i mëson nxënësit të mendojnë, një nga sfidat është që ata të ndihmohen të zbulojnë procesin e vlerësimit; miratimi dhe mosmiratimi i ideve të vetes është një proces i natyrshëm dhe i shëndoshë; besimi për të qenë vetëkritik mund të forcojë kuptimin e vetvetes.

Më poshtë jepen disa modele që nxësin të nxënësit formimin e aftësive si: *kompetencat, të menduarit kritik, krijues, qëndrimet dhe krijimtarinë*.

OBJEKTIVAT E ARRITJES PËR KLASËN E 10-të

Të ushqyerit e shëndetshëm	Objektivat specifikë
Niveli bazë	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë faktorët që ndikojnë në shprehjet tona të të ushqyerit; • të analizojë marrëdhënien ndërmjet ushqimit dhe shëndetit (shkallën e lartë të sëmundjeve që kanë lidhje me të ushqyerit si: diabeti, presioni i lartë i gjakut, sëmundjet e zemrës, rënia e dhëmbëve, dhjamosja, kanceri etj.).
Niveli mesëm	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të krahasojë traditën e tij të të ushqyerit me atë të nxënësve të tjerë; • të shpjegojë nevojën për kalori për grup moshat e ndryshme dhe për njerëzit e profesioneve të ndryshme; • të argumentojë pse është e shëndetshme një dietë e varfër në lyra të ngopura, në sheqer e në kripë; • të rekomandojë mënyra të shëndetshme për të humbur, për të fituar ose për të mbajtur peshën; • të llogarisë kaloritë e një vakti të ushqimit të tij.
Niveli i lartë	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë të ushqyerit e shëndetshëm si një nevojë për një zhvillim mendor optimal dhe një aktivitet shkollor maksimal (duke përfshirë këtu edhe zhvillimin e shëndetshëm të kockave dhe funksionimin e sistemit imunitar); • të argumentojë pse është e shëndetshme një dietë e pasur në perime e fruta; • të vlerësojë rekomandimet dietike, burimet dhe prirjet që burojnë nga prejardhje të ndryshme; • të hartojë një plan ushqyerje për një të ri të shëndetshëm, duke konsideruar dietën e balancuar, vlerën ushqyese, freskinë dhe kulturën; • të përfshihet në nisma për gatime të shëndetshme që mund të organizohen në klasë, në shkollë ose në bashkësi; • të hartojë një raport duke u mbështetur në të dhënat të marra nga botime të ndryshme ose nga interneti, për peshën trupore (anoreksia e forcuar dhe obeziteti).
Shëndeti	Objektivat specifikë

<p>Niveli bazë</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë për dimensionet e shëndetit (mirëqenies fizike, sociale, emocionale dhe intelektuale); • të rendisë sjellje dhe faktorë të rrezikshëm për shëndetin; • të evidentojë faktorët që ndikojnë në shëndetin e njeriut (trashëgimia dhe prirja e lindur ndaj disa sëmundjeve etj.).
<p>Niveli i mesëm</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të diskutojë për ndikimin e stereotipave, si: gjumi, higjiena, stresi, marrëdhëniet sociale, familjare dhe komunitare etj.); • të diskutojë për përgjegjësinë që ka individi për shëndetin e tij (kryerja e analizave periodike më të domosdoshme etj); • të evidentojë sëmundjet më të zakonshme tek adoleshentët.
<p>Niveli i lartë</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të zbulojë dhe të përpunojë informacionin e nevojshëm shëndetësor; • të ndërmarrë veprime për të mbrojtur shëndetin e tij dhe të tjerëve; • të kërkojë ndihmë të specializuar në rast nevoje.
<p>Alkooli dhe drogat e tjera</p>	<p>Objektivat specifike</p>
<p>Niveli bazë</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë dallimin e treguesve fizik, social dhe emocional gjatë abuzimit me substanca të dëmshme; • të përshkruajë ndikimin e përdorimit të alkoolit dhe drogave të tjera në ato zona të trurit të cilat kontrollojnë kujtesën, të parët, gjumin, koordinimin dhe kohën e reagimit; • të tregojë lidhjet ndërmjet alkoolit, duhanit dhe drogave të tjera dhe lindjes së fëmijëve me peshë të vogël, sindromës së vdekjeve të papritura të fëmijëve, paaftësive të tyre, sindromës së fëmijëve së alkoolizuar etj.

<p>Niveli mesëm</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të hulumtojë përdorimin e duhanit si një faktor shkaktar të sëmundjeve të: kancerit, zemrës, emfizemës etj; • të hulumtojë ndikimin e përdorimit dhe abuzimit me alkool në organet dhe sistemet e organeve të trupit të njeriut si: zemër, mushkëri, në sistemin kardiovaskular, riprodhues dhe atë imun; • të hulumtojë marrëdhëni në ndërmjet përdorimit të alkoolit e drogave të tjera dhe aksidenteve automobilistike.
<p>Niveli i lartë</p>	<p>Nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vlerësojë ndikimin e pirjes pasive të duhanit në shëndetin e fëmijëve, personave me alergji dhe astmë dhe të joduhanpirësve; • të paracaktojë ndikimet fizike, të sjelljes dhe ato ligjore të abuzimit me substanca të tilla: marihuana, heroina dhe drogave të tjera argëtuese; • të hulumtojë lidhjen midis përdorimit të drogave me injeksion dhe sëmundjeve si SIDA dhe Hepatiti B; • të analizojë lidhjen midis përdorimit të alkoolit, e drogave të tjera dhe incidenteve të përdhunimit, SST dhe shtatzënisë së padëshiruar; • të punojë për ndërgjegjësimin e familjarëve e komunitetit për dëmet me substancat abuzuese; • të ndihmojë personat që janë përdorues të substancave abuzive.

PJESA 2. METODOLOGJIA DHE MJETET

Tema: Metodatat dhe stilet e mësimdhënies së edukimit shëndetësor: piramida e të mësuarit

Përdorimi i një larmie metodash ndihmon jo vetëm në krijimin e një mjedisi mësimor më interesant, por edhe u përgjigjet nevojave të ndryshme mësimore të nxënësve.

Mësuesi ka përgjegjësi të krijojë në klasë një atmosferë të pranueshme për një të mësuar sa më të mirë. Piramida e të mësuarit sugjeron shumë stile të ndryshme të mësimdhënies. Prania e një larmie metodash e bën mësimdhënien më krijuese dhe u mundëson nxënësve ta vënë veten në provë në një mori rrugësh të ndryshme. Por ky fakt rrit edhe

nivelin e të kuptuarit dhe të përvetësuarit, pasi shumë prej metodave të piramidës bëjnë që aftësitë e grupit të përforcohen dhe të ngrenë më lart ndërveprimin midis nxënësve.

Shënim: Numri në kllapa tregon përqindjen e përafërt që mund të mbajë mend nxënësi. Përqindja e të përvetësuarit është mbështetur sa në metodën e mësimdhënies, aq edhe në nivelin e interesimit të nxënësit dhe në aftësitë e mësuesit.

Leksioni (5% përvetësim): Leksioni është një paraqitje e strukturuar dhe e organizuar e informacionit mbi një temë të caktuar që jep mësuesi. Leksioni është një mënyrë e shpejtë e dhënies së informacionit të përshtatshëm.

Megjithëse leksionet janë mjaft të dobishme, përsëri kanë edhe të meta. Ato mund të jenë të mërzitshme, sidomos kur zgjaten shumë dhe kur nuk i tërheqin nxënësit në mënyrë aktive. Leksionet i vënë nxënësit në pozitën e të dëgjuarit pasiv. Ato duhen kombinuar me metoda të tjera.

Leximi (10% përvetësim): Leximi individual ose në grup është, pa dyshim, një metodë e nevojshme të mësuarit, por, sikurse ndodh edhe me metodën e leksionit, leximi në vetvete nuk ofron mësim të integruar. Kombinimi i të lexuarit me metoda të tjera mësimi i pajis nxënësit me rrugë më të efekshme të mësuarit.

Mjetet audiovizive (20% përvetësim): Videokasetat, CD-të dhe filmat ofrojnë përforsime të ideve të paraqitura nga mësuesi. Përpara se të shfaqen në klasë, materialet audiovizive duhen paraparë me kujdes nga mësuesi. Të kombinuara me diskutime, ato mund të ngrenë ndjeshëm nivelin e njohurive të nxënësve.

Demonstrimi (30% përvetësim): Që të arrijë të mësojë diçka, nxënësit i duhet të mbështetet në shqisat e tij për ta çuar informacionin në tru. Përgjithësisht, nxënësit janë të prirur që një nga shqisat ta përdorin më shumë se të tjerat. Disa nxënës mësojnë më mirë me anë të të dëgjuarit, ka të tjerë që mësojnë më mirë duke lexuar ose duke parë figura, por ka edhe të tjerë që mësojnë më mirë me anë të të prekurit. Duke përdorur demonstrimet, mësuesit mund të ndihmojnë që nxënësit të mësojnë në të gjitha stilet e të mësuarit. Demonstrimet qëndrojnë në të gjitha tipat e mjeteve demonstrative. Fletëpalosjet, diapozitivat, pllakatet, fletët e punës, CD-të, janë disa nga mjetet që u vijnë në ndihmë nxënësve për të parë dhe dëgjuar ato që thotë mësuesi.

Diskutimi në grup (50% përvetësim): Diskutimet janë shkëmbime mendimesh të zhvilluara me gojë si ndërmjet nxënësve, ashtu edhe midis tyre dhe mësuesve. Ato u japin mundësinë t'u bëjnë të njohur të tjerëve idetë dhe pikëpamjet e tyre për një çështje të caktuar. Diskutimet janë mjaft të dobishme, pasi u krijojnë nxënësve mundësinë të vënë në përdorim aftësitë e tyre të menduarit, të zgjerohen rreth ideve që kanë si dhe të dëgjojnë mendime të ndryshme nga shokët e klasës. Diskutimet zgjerojnë dhe thellojnë dijet e nxënësve dhe u japin këtyre mundësi të zbatojnë ato çka kanë mësuar. Diskutimet në grupe, qoftë në grupe të mëdha apo të vogla, mund të përdoren gjatë gjithë zhvillimit të kapitullit.

Stuhia e mendimeve është një teknikë mjaft e njohur, e cila nxit rrjedhën e lirë të mendimeve rreth një çështjeje të caktuar, pra është renditja e ideve pa bërë diskutime për to. Klasës i jepet një temë dhe nxënësit ftohen të shprehin reagimet e menjëhershme për të. Reagimet renditen në dërrasën e zezë ose në një tabak letre. Rregullat për këtë teknikë janë:

- Pranohen të gjitha idetë dhe shkruhen në dërrasën e zezë.
- Asnjërit nuk i lejohet të shprehet pozitivisht dhe negativisht për idenë e tjetrit.
- Nxënësit ftohen të shprehin të gjitha idetë që u lindin, pavarësisht se mund të mos jenë të sigurt për to.
- Seanca mbyllet kur mësuesi e sheh se shteron dukshëm dhënia e ideve.

Stuhia e mendimeve si teknikë ka shumë përparësi. Ajo përdoret për shumë qëllime dhe në faza të ndryshme të orës së mësimi. Ajo mund të përdoret për t'i ndihmuar nxënësit të mendojnë në mënyrë krijuese, për të zhvilluar imagjinatën dhe ndjenjat rreth një problemi apo teme. Gjithashtu mund të përdoret si një veprimtari nxehjeje. Stuhia e mendimeve inkurajon secilin të marrë pjesë, pasi rregullat e mbrojnë nxënësin nga kritikata, tallja, të qeshurit. Është teknikë demokratike, sepse në thelb i njej kujtdo të drejtën të flasë dhe, ndërkohë, vlerëson ndihmesën e secilit.

Nëpërmjet praktikës vetjake (70% përvetësim): Loja me role është një bisedë, e shkurtër, e thjeshtë për t'u organizuar dhe elastike. Ajo zhvillon te nxënësit rrjedhshmërinë, nxit ndërveprimin në klasë duke i lënë hapësirë nismës dhe imagjinatës së nxënësit. Loja me role ngre në një shkallë të lartë motivimin. Nxënësit marrin një rol dhe e luajnë atë në një situatë të veçantë, pra roli është marrë nga një mjedis i caktuar dhe u kërkohet nxënësve të jenë krijues. Veprimtaria është e këndshme për

nxënësit. Loja me role ngre më lart besimin e nxënësit për veten.

Loja me role ka në qendër nxënësin. Nxënësit përdorin njohuritë që zotërojnë, përdorin strukturat e reja në mënyrë të lirë dhe i përdorin këto struktura në kontekste të reja.

Kjo metodë i stërvit nxënësit të përdorin gjuhën e folur, të komunikojnë lirshëm dhe të përdorin fjalorin jozyrtar. Ajo bazohet në situata jetësore dhe reale. Loja me role e ndihmon nxënësin e druajtur, i jep atij mundësi të shfaqë aftësitë e tij dhe i shton besimin në vetvete. Meqenëse loja me role është mjaft zbavitëse për fëmijët, ajo bën që të mbahet mend më shumë. Loja me role nuk ka spektatorë, sepse ajo nuk është një shfaqje. Loja me role nuk ka tension. Të nxënit është më i frytshëm në një atmosferë pa tension. Përdorimi i lojës me role zhvillon tek nxënësit aftësitë shoqërore. Nxënësit e ndiejnë se loja me role është interesante dhe nxitëse.

Duke mësuar të tjerët (90% përvetësim): Nxënësi që ua përcjell nxënësve të tjerë një informacion të caktuar, mban për vete 90% të materialit. Të jesh mesimdhënës bashkëmoshatar, përbën jo vetëm një mënyrë për të mësuar të tjerët, por edhe një nga mjetet më të efekshme për të përqendruar vëmendjen e nxënësve dhe për të ndryshuar sjelljet e tyre. Në metodat për të mësuar të tjerët mund të futet edhe stuhia e mendimeve, diskutimet shok me shok dhe lodrat. Çdo metodë krijuese që u mundëson nxënësve t'ia mësojnë materialin njëri-tjetrit, rrit përvetësimin prej tyre.

Metodologjia për zhvillimin e lëndës Aftësimi për jetën

Me konceptimin e kurrikulës së re të aftësisë për jetën, e rëndësishme është që, krahas ndryshimeve në përbërës të caktuar të saj (formë e përmbajtje), të përfshihen edhe problemet e mesimdhënies dhe të nxënit. Suksesi në njohuritë e kësaj lënde gjen shprehjen konkrete në përdorimin e metodave, strategjive e teknikave mësimore bashkëkohore *ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse*.

Janë pikërisht objektivat, synimet dhe standardet e vendosura për lëndën e aftësisë për jetën, ato që e drejtojnë mësuesin në mesimdhënien si shkencë.

Por bashkëpunimi midis “shkencës dhe artit” është i domosdoshëm në çdo hap të bërë gjatë procesit të të mësuarit.

Në rastin e mesimdhënies si *art*, për të arritur objektivin e caktuar, mësuesi është i lirë të zgjedhë metodën, teknikën e strategjinë e duhur, e

cila përcaktohet që më parë dhe pret të realizohet.

Kur flasim për një mësimdhënie ndërvepruese, duhet të kuptojmë mësimdhënien si një *akt bashkëveprimi, dinamik, elastik dhe të hapur*; midis mësuesit dhe nxënësve, por dhe midis nxënësve, ku të gjithë kanë të drejtë të marrin vendime dhe të zgjedhin rolet që u përshtaten.

Mësimdhënia duhet drejtuar në krijimin e njohurive, aftësive, të vlerave intelektuale, të qëndrimeve dhe të reflektimit individual dhe në grup.

Për të patur një ide më të qartë, le të shohin disa karakteristika që profilizojnë mësimdhënien pasive (me në qendër mësuesin) dhe atë aktive (me në qendër nxënësin).

NGA: <i>Mësimdhënie pasive</i>	NË: <i>Mësimdhënie me në qendër nxënësin</i>
Mësuesi shpjegon	Mësuesi drejton, orienton, udhëzon
Nxënësi dëgjon	Nxënësi përfshihet, vepron
Mësuesi pyet	Mësuesi i vë nxënësit të bëjnë pyetje
Nxënësi përgjigjet kur e pyesin	Nxënësi bën pyetje dhe kërkon përgjigje
Mësuesi flet	Mësuesi bisedon, diskuton, arsyeton, shkëmben ide
Nxënësi riprodhon	Nxënësi diskuton, arsyeton, argumenton
Mësuesi vlerëson	Mësuesi i përfshin nxënësit në vlerësim dhe vetëvlerësim
Mësuesi komandon	Mësuesi menaxhon, organizon
.....

Më poshtë po japim metodat me në qendër nxënësin dhe disa modele mësimi, në të cilat janë zbatuar disa nga këto metoda.



Modele mësimi

Tema: Shëndeti dhe sjellja

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësit duhet të:

- kuptojnë lidhjen midis shëndetit dhe sjelljes;
- klasifikojnë sjelljet në “shumë të rrezikshme”, “disi të rrezikshme” dhe “të parrezikshme”.

Procedura

Hapi i parë

Udhëzoni nxënësit që të dëgjojnë me vëmendje pyetjet e mëposhtme. U thoni atyre se, nëse edhe vetëm njëherë nga pyetjet ata me mend do t'i përgjigjeshin me *Po*, atëherë ata duhet të ngrihen në këmbë. Është mirë që

dhe ju në një moment të caktuar të ngriheni në këmbë, për të treguar se çdo njeri në jetën e përditshme bën veprime që rrezikojnë shëndetin. Me siguri që një numër i madh nxënësish, në mos të gjithë, do të ngrihen në këmbë. Në këtë rast theksohet lidhja që ekziston midis shëndetit dhe sjelljes së çdo njeriu.

1. A ndodh shpesh që të mos hani mëngjes?	PO	JO
2. A jeni më shumë se 7-10 kg. mbi peshën e rekomanduar?	PO	JO
3. A pini duhan	PO	JO
4. A e keni udhëtuar ndonjëherë me makinë pa përdorur rripin e sigurimit	PO	JO
5. A pini alkool (birrë apo verë) të paktën një herë në javë?	PO	JO
6. A keni udhëtuar ndonjëherë me makinë, drejtuesi i së cilës kishte pirë alkool?	PO	JO
7. A hani ushqime të llojit hamburger, më shumë se dy herë në javë?	PO	JO
8. A hani ushqime si p.sh.: patatina, biskota, karamelë ose akullore, më shumë se katër herë në javë?	PO	JO
9. A keni mbajtur ndonjëherë armë?	PO	JO

Hapi i dytë

Pasi nxënësit t’u përgjigjen pyetjeve, i udhëzoni ata t’i klasifikojnë sipas tabelës më poshtë dhe më pas diskutoni me nxënësit për qëndrimin e tyre.

Sjellje “Shumë të rrezikshme”	Sjellje “Disi të rrezikshme”	Sjellje “Të parrezikshme”
P.sh.: Pyetjet me numër:	P.sh.: Pyetjet me numër:	P.sh.: Pyetjet me numër:

Tema: Rreziqet e shëndetit nga abuzimi me drogë

Koha: 45 minuta.

Qëllimi: Paraqitja e fakteve mbi rreziqet e përdorimit të drogës për shëndetin.

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësit duhet të:

- kuptojnë dëmtimet e shëndetit nga përdorimi i drogës.

Më poshtë po japim një material ndihmës për mësuesit, më parë se të zhvillohet kjo veprimtari.

***Mjetet:** materiali ndihmës për mësuesin: Mite apo fakte, tabelë, shkumës dhe kuti.*

Plani i veprimtarisë:

Shumëfishoni materialin ndihmës për mësuesin “*Mite apo fakte*” dhe pritini thëniet në rripa. Palosini rripat dhe vendosini në kuti.

Hapi i parë

Pyetini nxënësit për substancat që njerëzit i fusin në trupin e tyre (ato që njohin nxënësit). Përgjigja duhet të jetë: drogë, alkool, duhan, ilaçe etj.

Vini në dukje se disa substanca, si vitaminat dhe ilaçet, kanë efekt pozitiv mbi shëndetin kur ato përdoren ashtu siç thotë mjeku. Por mund të jenë të dëmshme nëse abuzohet me to.

Shpjegoni se kjo veprimtari do të vlerësojë njohuritë e nxënësve mbi drogën dhe efektet e saj tek shëndeti.

Hapi i dytë

Ndajeni klasën në skuadra (kërkoni që nxënësit të emërtojnë skuadrat e tyre), të cilat do të konkurojnë për të parë se kush ka më shumë njohuri mbi drogën. Skuadrat marrin një pikë për çdo përgjigje të saktë.

Secili nxënës i skuadrave do të marrë me radhë nga kutia thënie mbi përdorimin e drogës. Disa nga thëniet janë të vërtetë, disa jo.

Pasi të ketë lexuar thënien me zë, nxënësit e skuadrës konsultohen me njëri-tjetrin për të dhënë përgjigjen më të mirë. Përgjigja duhet të jepet brenda kohës së caktuar. Nëse përgjigja është e saktë, skuadrës i jepet një pikë.

Kur skuadrat nuk e dinë përgjigjen e saktë, u jepni atyre

informacionin shtesë nga materiali ndihmës për mësuesin.

Kështu vazhdohet me të gjithë nxënësit e skuadrës tjetër. Vazhdoni derisa të gjithë anëtarët e skuadrave të kenë tërhequr nga një thënie. Mbani veprimtarinë në lëvizje; mos lejoni shumë kohë për përgjigjet (30-60 sekonda). Nxitni diskutimet për secilën thënie.

Përfundoni veprimtarinë me çështjet për diskutim.

Çështje për diskutim

1. Për çfarë drogash ose substancash flasin shokët tuaj?
2. Çfarë mitesh të tjera keni dëgjuar? Cilave prej tyre u besojnë ende shokët tuaj?
3. Cilat fakte ju çuditën? Cilat mite?
4. Cilat mite janë më të dëmshme? Pse?
5. Si mund t'i ndihmoni shokët tuaj që nuk kanë informacionin e duhur për llojet e drogave dhe përdorimin e tyre?

Material ndihmës për mësuesit

Mite dhe fakte

1. Alkooli është një substancë që krijon varësi, nuk është drogë.	2. Shumica e adoleshentëve përdorin më shumë alkoolin, sesa marijuanën.
3. T'i japësh makinës, pasi të kesh përdorur marijuanë, është më pak e rrezikshme sesa kur ke pirë alkool.	4. Kafja, çaji dhe shumë pije freskuese përmbajnë drogë.
5. Shumë rrallë mund të ndodhë që një adoleshent të jetë alkoolist.	6. Pirja e cigares mund të krijojë varësi.
7. Shumë të rritur që janë të varur nga droga të rrezikshme, mendojnë se pirja e marijuanës ishte hapi i parë që i çoi në një varësi të tillë.	8. Alkoolizmi është sëmundje.
9. Drogat i ndihmojnë njerëzit për të përballuar problemet dhe hallet e tyre.	10. Lëndët kimike, të lëngëta ose të gazta, nuk të dëmtojnë, megjithëse të rriturit i quajnë ato problematike.

11. Një kafë dhe një dush i ftohtë, ta nxjerrin pijen.	12. Alkooli ndikon tek disa njerëz më shumë sesa tek disa të tjerë.
13. Dy drogat që shkaktojnë numrin më të madh të vdekjeve, janë kokaina dhe heroina.	14. Pirja e duhanit dëmton gruan shtatzënë, por jo foshnjën e saj.
15. Disa dëmtime të shëndetit të njeriut mund të përmirësohen ose zhduken kur njerëzit e ndërpresin duhanin.	16. Marijuana përdoret legalisht për të trajtuar dhimbjet e mëdha të njerëzit me kancer.
17. Po të pish vetëm birrë, parandalohen problemet me alkoolin.	18. Alkoolizmi është tendencë e trashëgueshme.
19. Të pish rrallë cigare, nuk është e dëmshme.	20. Marijuana nuk të dëmton.
21. Alkooli kthehet në problem vetëm nëse e ke përdorur për vite të tëra.	22. Drogat si alkooli, marijuana dhe heroina, nuk do të përbënin problem për adoleshentët, nëse ata nuk do të ishin të varur prej tyre.

Mite dhe fakte mbi drogat dhe përdorimin e tyre.

(Shënim: Fjala mite ka kuptimin e një thënieje që nuk është e saktë)

Përgjigjet për secilën nga pohimet e mësipërme:

1. Mit

Alkooli është drogë, ashtu si çdo lloj substance që ndikon tek truri ose trupi i njeriut.

2. Fakt

Alkooli është substanca që përdoret më shumë nga adoleshentët. Përqindja e adoleshentëve që përdorin alkoolin, është shumë e lartë. Shumë e provojnë atë për herë të parë para moshës 13 vjeç.

3. Mit

Ashtu si alkooli, edhe marijuana ngadalëson refleksat në koordinimin e lëvizjeve dhe ndikon në perceptimin e njeriut (mënyrën si i shohim dhe i interpretojmë gjërat). Këto ndryshime shtojnë mundësinë e ndonjë aksidenti.

4. Fakt

Kafja, çaji dhe shumë pije freskuese përmbajnë kafeinë, që është stimulante. Kafeina krijon varësi prej saj; kur e ndërpret atë, dhimbja e kokës është shenjë e zakonshme.

5. Mit

Aspak! Shumë adoleshentë përdorin alkool (birrë, verë etj) çdo javë dhe shumë prej tyre kanë varësi nga pijet alkoolike.

6. Fakt

Shumë njerëz kanë varësi nga nikotina, më shumë se çdo substancë tjetër. Pirja e cigares është një zakon shumë i vështirë për t'u hequr, por ndërprerja e duhanit është shumë e rëndësishme për shëndetin.

7. Fakt

Si ata që janë të varur, edhe studiuesit e problemit të drogave, e shohin marijuanën si një drogë që hap rrugën drejt përdorimit të drogave të tjera.

8. Fakt

Alkoolizmi është sëmundje si diabeti, epilepsia ose sëmundje të tjera. Mund të kurohet dhe, për këtë, duhet që përdoruesit të eliminojnë konsumin e çdo lloj alkooli.

9. Mit

Drogat i ndihmojnë njerëzit **t'i harrojnë** problemet e tyre ose të reduktojnë dhimbjen e shkaktuar nga problemet. Sidoqoftë, problemet nuk ikin, shpesh ato keqësohen.

10. Mit

Të përdorësh lëndë kimike si benzina, llak flokësh, lëngje pastrues, ngjitësa të lëngshëm ose diluent, mund të jetë e rrezikshme. Ndryshe nga shumica e drogave, këto lëndë mund të shkaktojnë dëmtim të përhershëm të organeve si mëlçia, truri ose nervat.

11. Mit

Vetëm koha ta nxjerr alkoolin. Mëlçisë i nevojitet një orë për të përpunuar disa miligram alkool puro.

12. Fakt

Efekti i alkoolit ndikohet nga disa faktorë: pesha e trupit, sasia e alkoolit

të konsumuar, prania në trup i drogave të tjera, gjendja e përgjithshme shëndetësore e individit dhe nëse ka ngrënë apo jo.

13. Mit

Përdorimi i duhanit është shkaku kryesor i vdekjeve që mund parandalohen ndërsa alkooli është shkaktari i dytë i vdekjeve nga përdorimi i drogave.

14. Mit

Nëse gratë shtatzëna pinë duhan, fëmija mund të lindë para kohe dhe me peshë të vogël.

15. Fakt

Nëse nuk janë shkaktuar dëmtime të përhershme të zemrës dhe mushkërive, kur personi e ndërpret cigaren, trupi i tij mund të shërohet.

16. Mit

Përdorimi legal i marijuanës nuk lejohet.

17. Mit

Si tek birra, vera, edhe në pijet e tjera alkoolike ndodhet alkooli etilik, i cili dëmton rëndë shëndetin.

18. Fakt

Fëmijët e alkoolistëve kanë më shumë mundësi të bëhen alkoolistë, sesa fëmijët e prindërve joalkoolistë. Disa teori thonë se tek alkoolistët ekzistojnë përbërës të tillë kimikë që mund të trasnmetohen nga një brez në tjetrin.

19. Mit

Sapo njerëzit fillojnë të pinë cigare, atyre u krijohen njolla të verdha në dhëmbë, erë e keqe nga goja dhe vështirësi në frymëmarrje, gjë që mund të ndikojë negativisht në aktivitetin e tyre fizik. Varësia nga nikotina arrihet shumë shpejt. Ata që pinë duhan, kanë rrezik më të madh për të pasur kancer në mushkëri dhe sëmundje të tjera të mushkërive, kancer të gjuhës dhe fytit si dhe sëmundje të zemrës.

20. Mit

Megjithëse kërkimet vazhdojnë, shumë ekspertë besojnë se përdorimi i marijuanës për një kohë të gjatë është i rrezikshëm dhe mund të çojë në ulje të kujtesës, dëmtim të koordinimit, gjykim të dobët, dëmtim të sistemit riprodhues dhe irritim të fytit dhe mushkërive.

21. Mit

Kur dikush pi një gotë alkool, ai menjëherë ngadalëson kohën e reagimit, ndikon në ekuilibrin dhe ul reflekset. Kjo do të thotë që një atlet, kërcimtar, muzikant ose shofer mund të humbasë aftësitë e zakonshme, gjë që sjell

pasoja në cilësinë e punës që ata kryejnë.

22. Mit

Drogat e ndërpresin rritjen dhe zhvillimin normal të adoleshentëve. Ato u shkaktojnë atyre probleme me shkollën dhe në marrëdhëniet, shpeshherë çojnë në një shtatzëni të padëshiruar ose SST/HIV, sepse përdorimi i tyre nxit sjellje të rrezikshme.

Tema: Dhjetë gjëra që i bëj me qejf në vend që të pi duhan.

Koha: 20 minuta.

1. Objektivat: në fund të kësaj veprimtarie nxënësit duhet të:

- kuptojnë rëndësinë e marrjes me aktivitete për të shmangur fitimin e veseve.

Forma pune: Veprimtari, diskutim.

Mjetet e nevojshme: Letër dhe lapsa

Vendi: Klasa

Procedura

Hapi i parë

Udhëzohen nxënësit që në letrën format të heqin një vizë nga lart poshtë në mes të letrës, duke e ndarë atë në dy gjysma. Kërkojuni nxënësve që në anën e majtë të letrës të shkruajnë dhjetë gjëra që do të kishin dëshirë t'i bënin në vend që të pinin duhan. Duhet nxitur që ata të mendojnë në mënyrë sa më krijuese që të munden. Disa mund ta kenë të vështirë të mendojnë dhjetë gjëra. Sugjero disa prej tyre që mendon se njerëzit kanë dëshirë t'i bëjnë, si për shembull: të luajnë me top, të dëgjojnë muzikë, të vizatojnë, të shohin një film., të bisedojnë me një shok apo shoqe, të lexojnë një libër, të shëtisin etj.

Hapi i dytë

Pas plotësimit të listës, kërkoju nxënësve të ndajnë pjesën e djathtë të letrës në pesë kolona. Në krye të secilës kolonë, të shënohet me simbolet e mëposhtme:

Në kolonën e parë: **(P)**, *Para*

Në kolonën e dytë: **(Rr)**, *Rrezik*

Në kolonën e tretë: **(I)**, *Individ ose person*

Në kolonën e katërt: **(5)**, *pesë vitet e fundit*

Në kolonën e pestë: (!), *veprimtaritë e preferuara që janë në listë.*

- Në kolonën e parë **(P)** secili të shënojë me një **V** zërin ose zërat që

duan para (lekë) për t'i realizuar.

- Në kolonën e dytë (RR) të shënojnë zërin ose zërat të cilat mund të sjellin rrezik të mundshëm. Ky rrezik mund të jetë personal, shoqëror ose mendor.
- Në kolonën e tretë (I) të shënojnë ndonjë zë që i përcaktojnë ata si individë, domethënë si njerëz origjinalë.
- Në kolonën katërt (5) zërin ose zërat që mendojnë se gjatë pesë viteve të fundit nuk do t'i ketë më në listë.
- Në kolonën e pestë të shënojnë veprimtaritë e preferuara që aktualisht janë në listë.

Hapi i tretë

Ndaji pjesëmarrësit në grupe me nga katër vetë dhe caktoji çdo personi 2-3 minuta kohë që të flasë për listën e vet. Kërkoju t'i krahasojnë me njëri-tjetrin gjërat që pëlqejnë si dhe simbolet e ndryshme që kanë shënuar për to.

Potenciali

Ky aktivitet kërkon si fillim, që secili nxënës të punojë në mënyrë individuale, por më parë mësuesi duhet të qartësojë mirë qëllimin e aktivitetit për preferencat që mund të shprehë secili nxënës.

Diskutimi më pas mund të përqendrohet ndërmjet çifteve të nxënësve për secilën kolonë për të cilën ata kanë dëshirë.

Variacioni

Në qoftë se ju mendoni se hapi i dytë paraqet vështirësi për t'u realizuar nga nxënësit tuaj, ju mund të realizoni në kohën e planifikuar për këtë veprimtari hapin e parë dhe të tretë (duke u kërkuar nxënësve që të diskutojnë vetëm listën e gjërave që ata kanë dëshirë të bëjnë), pa e klasifikuar atë në pesë kolona.

Tema: Mësim mbi kontracepsionin

Gjatë këtij mësimi, mbani parasysh sugjerimet dhe udhëzimet e mëposhtme:

1. Tema e kontraktivëve është delikate për shumë njerëz. Përpjekjet për t'i mësuar nxënësit mbi përdorimin e kontraktivëve, mund të sjellë shumë diskutime e debate. Disa kanë bindjen se nxënësit

nuk duhet të kryejnë seks dhe kanë frikë se dhënia e informacionit mbi kontraktivët, do t'i inkurajojë ata për të eksperimentuar seksualisht. Por nuk ka prova se njohja e të rinjve me këtë lloj informacioni i nxit ata të kryejnë marrëdhënie seksuale.

Nëse, për arsye të ndryshme, nuk jeni në gjendje për të udhëhequr këtë veprimtari mbi kontraktivët, mund të ftoni një mjeke ose një punonjëse të planifikimit familjar. Sigurohuni që personi që do të ftoni, të ketë punuar më parë me adoleshentët të grupmoshës së nxënësve tuaj. Shpjegojini të ftuarit tuaj se qëllimi i këtij aktiviteti është informimi i nxënësve për seksin dhe për përdorimin e kontraktivëve në mënyrë që të ulin rrezikun e shtazënisë së padëshiruar, SST-së dhe infeksionit HIV.

2. Mos hamendësoni se ndonjë nga nxënësit tuaj kryen seks, ose asnjë nga nxënësit nuk kryen. Bëni të qartë se, përderisa shumica e njerëzve, gjatë jetës së tyre, kryejnë marrëdhënie seksuale, është e rëndësishme që të merret informacion mbi kontraktivët.

3. Paraqisni gjithmonë moskryerjen e seksit si metodën më efektive dhe më të përshtatshme për të rinjtë. Theksoni se, kur adoleshentët zgjedhin të kryejnë seks, ata kanë përgjegjësi për veten, partnerët e tyre dhe fëmijët e ardhshëm.

4. Mbani parasysh ndryshimet në kulturë dhe fe. Kur të flisni për marrjen e vendimeve mbi kontraktivët, rikujtojini nxënësit se çiftet gjithmonë duhet të marrin parasysh bindjet e tyre personale, familjare dhe fetare.

5. Përdorni vetën e tretë. Për shembull thoni “Nëse një çift shkon në qendrën e planifikimit familjar...”, ose “Kur dy njerëz vendosin të kryejnë seks...” Shmangni fjalitë e formës: “Nëse **ti** vendos të.....”, ose “Kur **ti** shkon në një qendër planifikimi familjar.....”.

6. Mbajini mendimet tuaja lidhur me mbajtjen e kontraktivëve jashtë diskutimit. Jepni informacion faktik rreth metodave të ndryshme dhe vazhdoni të përforconi konceptin se ata që vendosin të kryejnë seks, duhet të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe të përdorin kontraktivë.

7. Mos u tregoni atyre përvojën vetjake në përdorimin e kontraktivëve. Mund të përdorni shprehje si “Shumë femra/çifte/meshkuj që e përdorin atë metodë, mendojnë se.....”, ose “Një nga problemet që kam dëgjuar për të është.....”. nuk është mirë që t’ua tregosh përvojën vetjake nxënësve.

3. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi në lëndën “Aftësimi për jetën” do të fokusohet në aftësinë e zotërimit të koncepteve kyç dhe në mënyrë të veçantë, të zbatimit të këtyre koncepteve në situatat e jetës së përditshme.

Vlerësimi duhet t’i kushtojë kujdes të kuptuarit nga nxënësit të lidhjeve shkakësore dhe të ndërvarësisë së sjelljeve njerëzore dhe pasojave të tyre për shëndetin vetjak dhe atë të tjerëve.

Vlerësimi i aftësive do të vërë theksin në sjelljen e nxënësve në grup dhe aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme për marrjen e informacioneve të domosdoshme për vendimmarrjen dhe sjelljen e tyre.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Në këtë lëndë, vlerësimi i aftësive dhe i shprehive praktike në fushën e shëndetit dhe të sigurisë merr përparësi.

Mësuesi zhvillon vetë e ndihmon nxënësit dhe së bashku zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit në këtë lëndë mund të përfshijnë:

- teste me shkrim për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës së nxënësve në grup,
- punët eksperimentale, raportet e punës,
- aftësinë për të ndjekur procedura dhe rregulla të caktuara në situata praktike etj.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj.

Mësuesi nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore.

Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të materialeve mësimore të zhvilluara në klasë dhe të kryerjes së detyrave jashtë klase.

Kujtesë!

Numri i orëve gjithsej për zhvillimin e programit të lëndës “Aftësi për jetën” është 54 orë, të cilat ndahen sipas tri linjave, si më poshtë:

- 1. Linja 1: Edukimi shëndetësor 18 orë**
- 2. Linja 2: Sjellja e sigurt 18 orë**
- 3. Linja 3: Ndhimja e parë 18 orë**

Linja 1. Edukimi shëndetësor në këtë program ofron disa nënlinja. Numri i orëve për zhvillimin e tyre, në këtë program, është më i madh se 18 orë. Kjo do të thotë **se autori i tekstit do të ofrojë informacionin për të gjitha nënlinjat që përfshihen në program**, kurse shkolla ose mësuesi duhet të përzgjedhin atë nënlinjë që plotëson më mirë kërkesat e klasës, të shkollës ose të komunitetit në të cilin jetojnë. **Numri i orëve që do të përzgjedhë mësuesi për Linjën 1, nuk duhet të kalojë 18 orë mësimore.**

